

1 E martë, 17 dhjetor 2024
2 [Konferencë për Ecurinë e Çështjes]
3 [Seancë e hapur]
4 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]
5 [I akuzuari Kuçi paraqitet përmes videolidhjes]
6 [I akuzuari Thaçi paraqitet përmes
7 videolidhjes]
8 --- Seanca fillon në orën 14.00

9 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Mirëdita dhe mirë se
10 erdhët të gjithë në këtë konferencë të parë të ecurisë në këtë
11 çështje gjyqësore.

12 Znj. Sekretare, ju lutem paraqisni lëndën.

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita. Kjo është
14 lënda KSC-BC-2023-12, Prokuroria e Specializuar kundër Hashim
15 Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe
16 Hajredin Kuçit.

17 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, znj.
18 Sekretare.

19 Përpara se t'ju kërkoj atyre të pranishmëve në sallë ose
20 atyre që marrin pjesë përmes videolidhjes që të prezantohen,
21 do t'ju kërkoj të gjithëve që të respektoni rregullat në vijim
22 në mënyrë që të sigurojmë ecure të papenguar të kësaj seance.

23 Ju lutem, flisni ngadalë dhe qartë dhe prisni pesë
24 sekonda përpara se të më përgjigjeni mua apo ndonjë pale, në
25 mënyrë që përkthyesit të kenë kohë të përkthejnë dhe të

1 përfundojnë përkthimin.

2 Duke marrë parasysh se disa prej jush marrin pjesë në
3 këtë seancë fizikisht dhe të tjerë përmes lidhjes me video dhe
4 kemi gjashtë palë në këtë çështje gjyqësore, dhe në mënyrë që
5 të gjithë të mund të ndjekin procesin siç duhet, ju lutem të
6 mos flisni në të njëjtën kohë, prisni t'ju jepet fjala dhe më
7 pas të ndizni mikrofonin.

8 Dhe së fundi, në qoftë se ndonjëra nga palët apo ndonjë
9 përfaqësues i Zyrës Administrative do të marrë fjalën për të
10 ngritur ndonjë çështje ose për të dhënë përgjigje në atë që
11 thuhet, në qoftë se jeni në sallë duhet të çoheni në këmbë,
12 kurse ju që ndiqni përmes videolidhjes duhet të ngrini dorën.

13 Në rast të problemeve teknike ngrini dorën në qoftë se
14 këputet lidhja, ne duhet të bëjmë çmos që të rregullojmë
15 problemin teknik, në qoftë se kjo nuk mund të bëhet menjëherë,
16 do të bëj një pauzë të shkurtër për të rregulluar problemin
17 teknik.

18 Tani do t'i kërkoj Prokurorisë, Ekipeve të Mbrojtjes dhe
19 përfaqësuesit të Zyrës Administrative të prezantojnë ekipet e
20 tyre dhe veten, do fillojmë me Zyrën e Prokurorit të
21 Specializuar.

22 Z. HAFETZ: [Përkthim] Mirëdita. Unë jam Josh Hafetz, në
23 emër të Prokurorisë, unë jam këtu me kolegen Gaia Pergolo,
24 Fabian Unser-Nad dhe Line Perderson.

25 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, z.

1 Prokuror.

2 Tani fjalën e ka Mbrojtja, do të fillojmë me Mbrojtjen e
3 z. Thaçi e cila merr pjesë me videolidhje.

4 ZNJ. MENEGON: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Unë jam
5 Sophi Menegon dhe jam bashkëmbrojtëse e z. Thaçi. Ju
6 faleminderit.

7 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, Avokate
8 Menegon.

9 Për procesverbal, vërej se klienti juaj, z. Thaçi, e
10 ndjek këtë seancë përmes videolidhjes.

11 A na ndëgjoni, z. Thaçi?

12 I AKUZUARI THAÇI: [Përmes videolidhjes] Po.

13 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Shumë mirë. Faleminderit.
14 Tani Mbrojtja e z. Smakaj.

15 Z. MARTENS: [Përkthim] Mirëdita. Unë jam Bas Martens dhe
16 jam mbrojtësi i z. Smakaj.

17 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, z. Martens.

18 Dhe për hir të procesverbalit theksoj se klienti juaj, z.
19 Smakaj është i pranishëm në sallë të gjyqit.

20 Tani ia jap fjalën Mbrojtjes së z. Fazliu.

21 Z. PESTMAN: [Përkthim] Faleminderit. Unë jam Michiel
22 Pestman dhe jam Avokat Kujdestar për z. Fazliu.

23 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, z. Pestman.

24 Dhe për procesverbal, vërej se klienti juaj, z. Fazliu,
25 është i pranishëm në sallë të gjyqit.

1 Tani radhën e ka Mbrojtja e z. Kuçi që merr pjesë në këtë
2 seancë me anë të videolidhjes.

3 Z. ADMIRAAL: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Mirëdita, e
4 nderuar Gjykatëse. Unë jam Alexander Admiraal dhe jam Avokat
5 Kujdestar për z. Hajredin Kuçi.

6 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit. Për hir të
7 procesverbalit theksoj se klienti juaj ndjek këtë seancë
8 përmes videolidhjes.

9 Dhe përfaqësuesi i Sekretarisë do të konfirmojë se kush
10 është i pranishëm në atë dhomë.

11 ADMINISTRATORI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Unë, si
12 shef i Zyrës për Administrimin Gjyqësor, jam i pranishëm në
13 këtë dhomë së bashku me z. Kuçi.

14 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

15 Për z. Kilaj.

16 Z. EDWARDS: [Përkthim] Unë jam Iain Edwards dhe
17 përfaqësoj z. Kilaj.

18 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, z. Edwards.

19 Dhe për hir të procesverbalit, theksoj se z. Kilaj
20 gjithashtu është i pranishëm në sallë të gjyqit.

21 Tani radhën e ka Zyra Administrative.

22 Z. NILSSON: [Përkthim] Mirëdita. Unë jam Jonas Nilsson,
23 zëvendësadministrator dhe me mua është kolegja ime Whitney
24 Price.

25 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

1 Dhe për procesverbal, unë jam Gjykatësja e Procedurës
2 Paraprake në këtë seancë.

3 Më 10 dhjetor 2024, caktova datën për mbajtjen e kësaj
4 konference, në bazë të rregullës 96(1) të Rregullores dhe ju
5 kërkova palëve që të bëjnë parashtime me shkrim lidhur me
6 pikat në rendin e ditës që i bashkëlidhej atij urdhri.

7 Në pajtim mesa më lart, Administratorja dhe Prokuroria e
8 Specializuar paraqitën parashtimet e tyre më 12 dhjetor 2024,
9 e enjte, kurse Mbrojtja e z. Thaçi dhe ajo e z. Kilaj
10 parashtuan parashtimet e tyre me shkrim të premtën e shkuar,
11 më 13 dhjetor 2024.

12 Ju faleminderit palëve për parashtimet që dorëzuan
13 pavarësisht afatit të shkurtër.

14 Qëllimi i seancës së sotme është i dyfishtë: së pari, të
15 rishikohet gjendja apo statusi i çështjes dhe të organizohen
16 shkëmbime midis palëve; dhe e dyta, t'i mundësohet z. Thaçi
17 dhe z. Smakaj të bëjnë vetëdeklarimin, në bazë të rregullës
18 92, në qoftë se dëshirojnë. Për menaxhimin e kohës, dua të
19 kërkoj nga Mbrojtja e z. Thaçi dhe Mbrojtja e z. Smakaj të më
20 përgjigjen në qoftë se klientët e tyre janë të gatshëm të
21 bëjnë vetëdeklarimin sot.

22 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Ju faleminderit, e nderuar
23 Gjykatëse. Në këtë fazë klienti im nuk dëshiron të bëjë
24 vetëdeklarimin.

25 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

1 Po ju?

2 Z. MARTENS: [Përkthim] E njëjta gjë vlen edhe për
3 klientin tim.

4 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit. Meqë të dy
5 keni zgjedhur që të mos bëni vetëdeklarimin sot, rikujtoj
6 udhëzimet që i kam përcaktuar në urdhrin për caktimin e kësaj
7 seance sot dhe ju ftoj që të bëni vetëdeklarimin, në qoftë se
8 do të bëni, në formë të shkruar deri më datën 7 janar 2025, në
9 orën 12.00.

10 Në qoftë se vendosni që të mos e përdorni këtë të drejtë,
11 atëherë unë në emrin tuaj do të bëj vetëdeklarimin si të
12 pafajshëm në përputhje me rregullën 95.

13 Arsyeja, siç thashë, e këtij takimi sot është që të
14 organizohen shkëmbime midis palëve për të siguruar ecurinë e
15 shpejtë të procesit. Jemi në një fazë të hershme të procesit
16 të nxjerrjes së materialeve që si proces do të fillojë
17 plotësisht me nxjerrjen e Urdhrit Kornizë për nxjerrjen e
18 provave. Këtë vendim planifikoj ta nxjerr pas seancës së sotme
19 përkatësisht të premtën më 20 dhjetor 2024.

20 Gjithashtu, jam e vetëdijshme që ekipet e Mbrojtjes
21 ndoshta nuk janë në gjendje t'u përgjigjen të gjitha pyetjeve
22 të parashtuara për këtë konferencë sot. Dhe në këtë fazë të
23 hershme, sigurisht, që nuk pres përgjigje të plotë nga palët,
24 por thjesht kërkoj që palët të angazhohen me zell në procesin
25 që po e fillojmë sot.

1 Tani do të ndjek dhe rendin e ditës që është shtojcë e
2 urdhrit për caktimin e datës së kësaj konference.

3 I kam lexuar parashtimet e Zyrës së Prokurorit dhe ato
4 të Mbrojtjes së z. Kilaj dhe Thaçi. Ju kërkoj palëve dhe
5 përfaqësuesit të Zyrës Administrative që të mos i përsërisin
6 parashtimet që i kanë bërë me shkrim. Po thjesht, në qoftë se
7 e gjykojnë të nevojshme, të bëjnë ndonjë parashtim plotësues,
8 atëherë atë mund ta bëjnë gojarisht.

9 Mbrojtja e z. Smakaj -- do ta përfundoj fjalinë dhe do
10 t'ia jap fjalën z. Thaçi.

11 Mbrojtja e z. Smakaj, z. Fazliu dhe z. Kilaj, ftohen që
12 të bëjnë parashtime në mënyrë të përqendruar dhe të shkurtër.

13 Z. Thaçi, keni ngritur dorën dhe unë jua jap fjalën.

14 I AKUZUARI THAÇI: [Përmes videolidhjes] Faleminderit, e
15 nderuara Gjykatëse. Siç e tha dhe avokatja, para se të
16 deklarohej, unë dëshiroj që të shtoj dhe diçka pikërisht në
17 këtë fazë të hershme të këtij procesi për mbarëvajtjen e
18 rregullt kushtetues dhe ligjor që duhet të ndodhë.

19 Ju e dini para katër vitesh, në nëntor 2020, u ngrit
20 aktakuzë kundër meje vetëm tre muaj para se të rizgjidhesha
21 president i vendit. Tash, para dhjetë ditësh, nxitimthi, Zyra
22 e Prokurorit prezantoi aktakuzë shtesë vetëm dy muaj para
23 zgjedhjeje parlamentare në Kosovë. Unë dua të sqaroj edhe një
24 herë: Unë nuk jam pjesë e garës politike e as nuk kam ndonjë
25 ambicie politike as për president, as për kryeministër, as për

1 deputet e as ndonjë ambicie tjetër për ndonjë pozitë publike.
2 Ritheksoj se nuk jam pengesë e as nuk paraqes rrezik për
3 askënd, në kuptimin politik, e as për ndonjë projekt
4 qeverisësh.

5 Gjithë jetën time, kam punuar për lirinë dhe shtetin e
6 Kosovës me vizionin për anëtarësim në NATO, në Bashkim
7 Evropian, në raport special të përjetshëm me Shtetet e
8 Bashkuara të Amerikës.

9 Por, e nderuara Gjyqtare, dëshiroj të ritheksoj dhe
10 nënvijëzoj domosdoshmërinë e respektimit të kushtetutës dhe
11 ligjeve të Kosovës në këtë sallë. Mosrespektimi i kushtetutës
12 dhe ligjeve të Kosovës dhe normave tjera ligjore nga palët në
13 këtë sallë të shenjtë për drejtësinë paraqet rrezik për
14 minimin e demokracisë në Kosovë, paraqet rrezik për cenimin e
15 besimit qytetar. Prandaj ftoj që të ruhet vetëpërmbajtja
16 institucionale nga të gjithë edhe në këtë sallë.

17 Ju faleminderit.

18 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, z. Thaçi.
19 Kjo është tani në procesverbal dhe ka hyrë dhe në procesverbal
20 të seancës së paraqitjes së parë, në qoftë se nuk e kam gabim.

21 Tani ju rikujtoj palëve që të japin njoftim paraprak në
22 qoftë se parashtrimet e tyre kanë të bëjnë me informacion
23 konfidencial në mënyrë që të kalojmë në seancë private.

24 Së fundi, kam marrë parasysh kërkesat për riklasifikim që
25 kanë paraqitur palët. Do të bëj disa sqarime dhe të jap urdhra

1 gojorë gjatë seancës së sotme në lidhje me ato kërkesa.

2 Tani të kalojmë tek pika e parë e rendit të ditës që ka
3 të bëjë me pyetjet e përgjithshme.

4 Përpara se t'ua jap fjalën palëve, rikujtoj se parimet e
5 përgjithshme të nxjerrjes së materialeve janë të përcaktuara
6 në kuadrin ligjor të Dhomave të Specializuara dhe sipas këtyre
7 parimeve palët --

8 Nxjerrja e materialeve bëhet midis palëve *inter partes*,
9 pra, në formë elektronike, në mënyrë të organizuar dhe të
10 mundësuar përmes Zyrës Administrative dhe Sistemit të
11 Administrimit Gjyqësor. Nxjerrja duhet të bëhet prioritet për
12 Prokurorinë në këtë fazë, dhe palët duhet të nxjerrin provat
13 që janë me vlerë të vërtetë provuese dhe jo për nga sasia të
14 shumta. Ky është thelbi i procesit.

15 Për të respektuar parimin e procesit publik, provat
16 regjistrohen si publike përveçse kur ka arsye për klasifikim
17 tjetër të tyre.

18 Unë i kërkoj Zyrës së Prokurorit të Specializuar që të
19 përgjigjet në grupin e parë të pyetjeve të rendit të ditës
20 përkatësisht për statusin e hetimeve të Mbrojtjes, pika 1(a),
21 veçanërisht hetimeve forensike, pika 1(b), për llojin dhe
22 numrin e provave që synon të përdorë gjatë procedurës, pika
23 1(d), përdorimi i *software* apo mjeteve të posaçme për qasje në
24 prova, pika 1(e) dhe në sa dëshmitarë është mbështetur
25 Prokuroria për këtë Aktakuzën e Konfirmuar dhe sa synon të

1 thërrasë për të dhënë në gjykim dëshmi, pika 1(f).

2 Për të kursyer kohë, do të përmbledh parashtimet me
3 shkrim të ZPS-së: Hetimi kryesor në këtë çështje është
4 pothuajse i përfunduar, po mbeten dhe disa hapa hetimorë për
5 t'u marrë të cilat mund të gjenerojnë prova shtesë.

6 Autorizimi gjyqësor për shqyrtimin forensik të provave të
7 konfiskuara nga z. Fazliu më 4 dhjetor 2024 do të kërkohet, e
8 di që për këtë kërkesë m'u bë njoftim sot në mëngjes dhe është
9 parashtimi F88 dhe këtij do t'i kthehem më pas gjatë kësaj
10 seance.

11 ZPS-ja është në pritje të disa rezultateve të analizave
12 forensike të provave që janë marrë z. Kilaj, dhe mbasi të ketë
13 qasje në përmbajtjen e këtyre provave, atëherë do të
14 përfundojë në kohën e duhur shqyrtimin e atyre provave dhe do
15 të bëjnë nxjerrjet e materialeve sipas rregullës. Në këtë
16 kontekst, ZPS-ja sqaron se ka dy materiale provuese në zotërim
17 për të cilat ekzaminimi ende nuk ka përfunduar dhe është
18 kërkuar nga instituti forensik i jashtëm që të përcaktojë
19 prioritetet në këtë aspekt.

20 Në lidhje me këto parashtime, kam marrë parasysh
21 shqetësimet që ka ngritur z. Kilaj se kjo procedurë paraprake
22 mund të vonohet për shkak se ZPS-ja ende nuk ka qasje në
23 pajisjet elektronike të z. Kilaj. Ai pretendon se nuk duhet
24 t'i bëhen favore të mëtejshme Prokurorisë për sa i përket
25 ecurisë së shpejtë të procesit paraprak.

1 Në Aktakuzën e Konfirmuar, ZPS-ja mbështetet në një
2 dëshmitar. Ka ndërmend që të thërrasë tre dëshmitarë në
3 gjykim, mirëpo ky numër mund të ndryshojë. ZPS-ja synon të
4 paraqesë apo të përdorë gjatë këtij procesi: incizime me zë,
5 prova të tjera të marra nga pajisje elektronike ose nga
6 telefona mobil, të dhëna të thirrjeve telefonike, dokumente
7 zyrtare të qendrës së paraburgimit të Dhomat e Specializuara
8 dhe prova fizike të marra gjatë operacioneve të kontrollit dhe
9 sekuestrimit.

10 Për qasje në përmbajtjen e këtyre mjeteve elektronike,
11 ZPS-ja do t'i japë Mbrojtjes softuerin e nevojshëm.

12 Në lidhje me këto parashtime, gjithashtu vë në dukje
13 shqetësimet e z. Kilaj se vetëm materiali që ZPS-ja ka
14 ndërmend të përdorë gjatë gjykimit ose që është potencialisht
15 shfajësues duhet t'u nxirret të bashkakuzuarve tjerë për të
16 shmangur çdo shkelje të panevojshme të drejtës së z. Kilaj për
17 privatësi.

18 Pas kësaj përmbledhje të parashtimeve të ZPS-së në
19 lidhje me pyetjet e përgjithshme, do t'i jap fjalën ZPS-së që
20 t'i plotësojë këto parashtime. Kërkoj prej ZPS-së që brenda
21 këtyre parashtimeve gojore t'i trajtojë dhe shqetësimet që ka
22 ngritur Mbrojtja e z. Kilaj. Dhe gjithashtu në parashtime të
23 përfshijë dhe parashtime shtesë në lidhje me dy materialet që
24 janë aktualisht në zotërim të ZPS-së për të cilat z. Kilaj ka
25 kërkuar sqarim të mëtejshëm.

1 Z. HAFETZ: [Përkthim] Do filloj nga pyetja e fundit.
2 Telefoni i z. Kilaj është një prej këtyre elementëve.
3 Domethënë, kjo është një prej mjeteve të cilat ne kemi në
4 zotërim. Ndërkohë që mjete tjetër është telefoni tjetër që ju
5 e keni përmendur më herët që është telefoni i z. Fazliu, për
6 të cilin ne kemi bërë parashtimet mbi bazën e kërkesës tuaj.

7 Sa i takon çështjeve të tjera, nuk kam asgjë tjetër për
8 të shtuar përveçse të trajtoj aspektin që ka ngritur z. Kilaj
9 lidhur me trajtimin e nxjerrjes së informacionit nga telefoni
10 i tij. Më duhet të them që tani që shqetësimi i tij është
11 mbajtur shënim prej nesh. Dhe ne do të konsultohemi me
12 avokatin për këdo telefon i të cilit është sekuestruar. Mbase
13 qasja që do të ndjekim do jetë e ndryshme, megjithatë ne do të
14 bashkëpunojmë me Ekipet e Mbrojtjes në qoftë se kanë ndonjë
15 shqetësim të tillë lidhur me këtë pikë.

16 Ndërkohë që sa i takon shqetësimit të z. Kilaj, ne
17 parashtojmë që ai është i parakohshëm. Dhe aktualisht nuk
18 mund të themi asgjë tjetër lidhur me të.

19 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Tani do të vazhdojmë me
20 Ekipet e Mbrojtjes, do të vazhdojmë me Mbrojtjen e z. Thaçi si
21 fillim.

22 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Për momentin nuk kemi asgjë për
23 të shtuar.

24 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull.

25 Tani e keni fjalën ju, Avokati Martens.

1 Z. MARTENS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.
2 Unë kam një konstatim ose një parashtrim të posaçëm që ka të
3 bëjë me pyetjet 1(4) dhe pikat (h), (i) dhe (j), domethënë, në
4 qoftë se do të më jepni mundësi do të mundohem që t'i
5 parashtroj këto pika pak më vonë.

6 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] A kanë të bëjnë me
7 pyetjet e përgjithshme këto shpjegime apo shtjellime që doni
8 të jepni?

9 Z. MARTENS: [Përkthim] Janë pyetje të përgjithshme, por
10 janë nën pikën 1(h), (i) dhe (j). Në qoftë se është momenti i
11 përshtatshëm mund t'i shtjelloj dhe tani.

12 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Po, vazhdoni. Tani është
13 momenti i përshtatshëm.

14 Z. MARTENS: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, palët e
15 pranishme këtu, më lejonin të them që 14 muaj më përpara
16 shtëpia e z. Smakaj është kontrolluar, ndërkohë që në tetor më
17 datë 30 tetor 2023. 12 muaj më përpara ose më duhet të them,
18 që për të qenë më ekzakt. Më datën 1 korrik të këtij viti,
19 gjashtë muaj më përpara, ZPS-ja ka kërkuar miratimin e një
20 fletë-arresti nga Gjykatësi i Vetëm i Dhomat e Specializuara
21 të Kosovës.

22 Ndërkohë që më datë 29 nëntor, aktakuza u konfirmua
23 kundër z. Smakaj dhe të tjerëve. Ndërkohë që më 9 nëntor, z.
24 Smakaj është paraqitur në paraqitjen e parë në seancën e parë
25 të organizuar, sikurse e dini.

1 Ndërkohë që z. Smakaj është në paraburgim për thujajse dy
2 javë. Mbrojtja ka marrë tani rreth 80 dokumente për këtë
3 çështje.

4 Sa i takon provave. Më lejoni të them që ka një dokument,
5 pra, është dokumenti i cili ka numrin 69, që na jep
6 informacion sa i takon provave, megjithatë çdo gjë që ka të
7 bëjë me z. Smakaj është redaktuar dhe është i gjithi i nxirë,
8 në veçanti lidhur me dokumente të cilat janë sekuestruar gjatë
9 kontrollit në banesën e tij. Për shembull, informacioni që ka
10 të bëjë me të dhënat telefonike është shumë i kufizuar. Për
11 rrjedhojë, në përgjigje të pyetjeve të përgjithshme, pra,
12 pyetjes 1(h) dhe (i), Mbrojtja aktualisht nuk mund të bëjë
13 asnjë hetim dhe nuk mund të bëjë asgjë sa i takon, pra,
14 rezervave ose sa i takon qasjeve të Mbrojtjes në mënyrë të
15 tillë që ajo mund të vazhdojë me hetimet e veta, domethënë,
16 për momentin nuk bëjmë dot asgjë por rezervojmë të drejtën për
17 të marrë hapa kur të jetë e përshtatshme.

18 Tani në reagim të parashtimeve të Prokurorisë dhe
19 qëndrimi i Mbrojtjes sa i takon pyetjes 1(j), të pyetjeve të
20 përgjithshme, neve parashtojmë si më poshtë. ZPS-ja deklaron
21 që hetimi dhe cilësoj dhe e citoj këtu është "pothuajse i
22 plotë. Ka ende sisa hapa të tjerë të cilët do të duhet që të
23 merren në kuadrin e hetimeve. Rishikimi ose analiza nga palët
24 e treta i provave të caktuara sa i takon privilegjeve ligjore
25 është i nevojshëm".

1 Mbroytja i kërkon ZPS-së që të thotë se sa kohë do të
2 duhet që të përmbushet detyrimi i ZPS-së sa i takon z. Smakaj.
3 Duket sikur është e mundur që provat të mund të jenë çështje
4 që kanë të bëjnë me privilegje ligjore dhe janë të përfshirë
5 dhe si rezultat do të duhet që këto duhet që të jepen
6 menjëherë. ZPS-ja në çështjen kundër z. Smakaj, sipas mendimit
7 tonë, ka pasur kohë të mjaftueshme, sikurse e përmendët dhe ju
8 në prezantimin tuaj, në mënyrë të tillë që të përmbushë
9 rregullat për privilegj juridik.

10 ZPS-ja parashtrohet që është e gatshme që të nxjerrë të
11 gjithë materialet të cilat mbulohen nga rregulla 102(1)(a)
12 menjëherë. Ndërkohë që Mbroytja kërkon, ju kërkon juve, e
13 nderuar Gjykatëse, që të vendosni që kjo të bëhet sot, duke na
14 lënë neve disa ditë në dispozicion përpara Krishtlindjeve në
15 mënyrë të tillë që të bëjmë rishikimet e nevojshme dhe të
16 bëjmë parashtrimet tona.

17 ZPS-ja deklaron dhe gatishmërinë e saj për të parashtruar
18 prova të tjera të mbuluara nga rregulla 102(1)(b) në mënyrë
19 graduale nga data 20 dhjetor, që i takon që është e premtja e
20 ardhshme. Edhe sa i takon kësaj pike, Mbroytja kërkon, e
21 nderuar Gjykatëse, që ju të vendosni dhe t'i kërkon
22 Prokurorisë që të lëshojë material sa më shpejt të jetë e
23 mundur, mundësisht sot për arsyet që unë i ceka dhe më sipër.

24 Kemi kundërshtim sa i takon nxjerrjes së provave në
25 mënyrë graduale. Mbroytja ka qëndrimin që i gjithë materiali i

1 disponueshëm duhet që të dorëzohet për Ekipet e Mbrojtjes
2 menjëherë në mënyrë të tillë që Mbrojtja të përgatitet siç
3 duhet dhe të përpunojë të gjithë materialin në rastin e z.
4 Smakaj të cilit aktualisht i është mohuar liria.

5 Sa i takon materialit që mbulohet nga rregulla 102(3), ky
6 është material i cili Mbrojtjes i duhet menjëherë, vërehet që
7 ZPS-ja ka dhënë një shpjegim të vagullt sa i takon posedimit
8 të këtij materiali. Përsëri, Mbrojtja kundërshton nxjerrjen e
9 këtij materiali në mënyrë graduale. Është e domosdoshme, sipas
10 nesh, që këto materiale mund të jepen sot.

11 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Avokati Martens, ishte
12 faji im. Në fakt, këto materiale do të diskutohen pak më vonë.
13 Ju kishit të drejtë kur ndërhytë, kështu që këtë çështje do e
14 diskutojmë pak më vonë.

15 Z. MARTENS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

16 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në çdo rast, kjo që ju
17 sapo thatë u shënua, pra, u mbajt parasysh.

18 Tani ZPS-ja nuk e dini në qoftë se doni t'i përgjigjeni
19 tani apo të përgjigjeni më vonë?

20 Në rregull. Mund të vazhdojmë me pyetje të përgjithshme
21 të cilat unë i kam ngritur dhe më përpara, kështu që për këtë
22 arsye do t'i jap fjalën Avokatit Pestman.

23 Z. PESTMAN: [Përkthim] Faleminderit shumë, Gjykatëse. Unë
24 kam disa pika për të ngritur edhe disa komente po ashtu.

25 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Sa për ta specifikuar,

1 Avokat, sigurisht që më vonë do trajtoj parashtrimin e
2 paradites, e ditës së sotme, domethënë, që është parashtrimi
3 F88, që lidhet konkretisht me z. Fazliu, sa për ta ditur.

4 Z. PESTMAN: [Përkthim] Sa i takon parashtrimin që ju sapo
5 përmendët, ky është një parashtrim i cili ka të bëjë me
6 telefonin? Po ndërkohë unë personalisht nuk e kam parë fare
7 këtë telefon. Sistemin e kam hapur dje, po ndërkohë që nuk kam
8 pasur qasje në këtë parashtrim, kështu që thjesht po ju them
9 që nuk kam qasje në këtë dokument. Domethënë, ky është një
10 dokument i cili është ngarkuar vetëm në sistemin *Legal*
11 *Workflow*, ndërkohë që unë nuk kam pasur mundësi që ta aksesoj,
12 nuk e kam lexuar.

13 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Një konstatim. Është
14 vërtetë, domethënë, klasifikimi është konfidencial, ju duhet
15 të keni pasur qasje në këtë dokument. Kështu që për çdo qasje
16 apo problem logjistik ose që lidhet me aspektet e IT-së duhet
17 që të kontaktoni me Zyrën Administrative në mënyrë të tillë që
18 të mos keni problem.

19 Nuk e di në qoftë se Ndhmësadministratori dëshiron që të
20 marrë fjalën për të bërë ndonjë shpjegim.

21 Z. NILSSON: [Përkthim] Jo, nuk është e nevojshme besoj.
22 Megjithatë ne jemi të gatshëm që të ndihmojmë kurdo që ta
23 shikoj të arsyeshme Avokati.

24 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Fjala përsëri për ju,
25 Avokat.

1 Z. PESTMAN: [Përkthim] Po, në rregull. Do kontaktoj me
2 Zyrën Administrative pas seancës.

3 Atëherë nuk është se mund të them shumë lidhur me këtë
4 parashtrim sepse parashtrimin nuk e kam parë sikurse e thashë
5 dhe më sipër.

6 Sa i takon pikës 11 në parashtrimet e Prokurorisë për
7 këtë seancë konkrete, unë e kuptoj që kjo ka qenë në përgjigje
8 të pyetjes 1(f) të rendit të ditës. Mesa kuptoj unë, ZPS-ja
9 synon që të mbështetet tek deklaratata ose të paktën në
10 Aktakuzën e Konfirmuar. Ose ta them ndryshe, ZPS-ja parashikon
11 që të paktën do thërrasë tre dëshmitarë për të dhënë dëshmi në
12 gjykim.

13 Unë dua të di se me cilat nënçështje lidhen këto
14 dëshmitarë, me cilët individë ose me cilët të akuzuar lidhen
15 këto dëshmitarë. Domethënë, a bëhet fjalë për dëshmitarë, për
16 tre dëshmitarë që do thërriten për të gjithë, për të katër të
17 akuzuarit apo jo? Dhe gjithashtu do të doja që të dija në
18 qoftë se Prokuroria mund të na thonë në qoftë se këta
19 dëshmitarë do lidhen me klientin tim apo me klientët e
20 kolegëve të tjerë të mitë?

21 Këtë pyetje kam për ZPS-në.

22 Ndërkohë në përgjigje të pyetjes që bëtë më herë,
23 Gjykatëse, për pyetjen 1(h), (i) dhe (j) unë kam një përgjigje
24 shumë të shkurtër. Nuk kam mundësi që t'ju jap një përgjigje
25 lidhur me këto pika.

1 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Do kalojmë, do i vijë
2 radha dhe këtyre pikave.

3 Z. PESTMAN: [Përkthim] Faleminderit.

4 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit juve.

5 Avokati Admiraal, përpara sesa të vazhdojmë më tej --

6 Z. HAFETZ: [Përkthim] Po, mund t'i jepni avokatit
7 përgjigjen.

8 Z. ADMIRAAL: [Përkthim] Nuk kam parashtrime për momentin,
9 Gjykatëse.

10 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull.

11 Tani, Edwards. Nuk e di, keni diçka për të shtuar, ndonjë
12 shtesë lidhur me atë çfarë keni parashtruar me shkrim?

13 Z. EDWARDS: [Përkthim] Kam vetëm një pikë për të ngritur.
14 Domethënë, është një pikë të cilën e kemi ngritur edhe në
15 parashtrimin tonë. Ajo ç'kam për të thënë është që ndërkohë që
16 është inkurajuese që Prokuroria thotë që do hyjë në biseda me
17 palët, pra, me avokatët për sa i takon elementëve dhe sendeve
18 për të cilat janë parashtruar apo telefonave më konkretisht,
19 në parashtrimin tim Prokuroria nuk ka të drejtë që të thotë që
20 është e parakohshme që të përfshihemi në diskutime thjesht
21 lidhur me çështjen se çfarë është informacioni në secilin prej
22 telefonave i cili duhet të nxirret për ekipet e Mbrojtjes. Ne
23 mendojmë që është çështje parimi që vetëm provat të cilat janë
24 relevante ose në lidhje me çështjen do të duhen që të nxirren
25 për palët.

1 Kështu që në emër të z. Kilaj, duke qenë avokati i tij,
2 unë parashtroj që fotografitë e pushimeve ose mesazhe ku
3 thuhet që ça duhen që të blihen në shitore nuk kanë asnjë lloj
4 relevante. Nuk ka asnjë lloj baze ose nuk ka asnjë lloj
5 shpjegimi që do justifikonte përdorimin e këtij informacioni,
6 ndërkohë që Prokuroria thotë që është e parakohshme që të
7 përfshihemi në këtë diskutim, kështu që ne jemi absolutisht jo
8 dakord me Prokurorinë dhe mendojmë që duhet të merren parasysh
9 vetëm ato informacione që kanë lidhje me çështjen.

10 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull.

11 Avokati Pestman.

12 Z. PESTMAN: [Përkthim] Pasi dëgjova kolegun, nuk e kisha
13 kuptuar në fakt deri tani që informacioni që ishte ose që
14 është në telefonin e klientit tim mund t'i nxirret palëve të
15 tjera. Domethënë, a mund të na shpjegoni a bëhet fjalë që do
16 bëhet një nxjerrje e madhe e informacioneve, në kuptimin që të
17 gjitha palët do të marrin informacionin, apo jo? Megjithatë,
18 parashtrimi im është që informacioni që gjendet në telefonin e
19 klientit tim duhet thjesht të lidhet me çështjen e klientit
20 tim dhe nuk duhet t'i bëhet me dije palëve të tjera.

21 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Prokuror, fjala për ju.

22 Z. HAFETZ: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, mund ta
23 trajtoj tani ose dhe më vonë këtë pikë, sikurse e thashë edhe
24 më përpara, ne do të përfshihemi, do të bisedojmë me palët
25 lidhur me telefonat që janë sekuestruar nga klientët e tyre.

1 Sa i takon z. Kilaj, sikurse e thashë dhe më përpara, kërkesa
2 nga Mbrojtja është e parakohshme sepse ne nuk e kemi vendosur
3 se çfarë do të nxirret në pikën 1(a) dhe (b).

4 Dhe, së dyti, dua që t'ju them kolegëve që ne i dimë
5 detyrimet tona për parashtrimet. Atëherë ne nuk do të nxjerrim
6 informacion që bie në rregullin 120(a)(b), vetëm atë
7 informacion që lidhet me çështjen, që është relevante dhe që
8 sipas përcaktimeve që parashikohen në Rregullore.

9 Pra, më duhet të them gjithashtu që kemi një çështje.
10 Një, pra, është një çështje që përmban pesë të akuzuarit.

11 Por, ne do të përfshihemi, do të kontaktojmë me avokatët
12 sa i takon interesave të tyre ose ndjesive të tyre për të
13 nxjerrë informacione të telefonave të tyre. Sepse ka dhe
14 telefona të personave të tjerë të cilët janë sekuestruar si
15 pjesë e kësaj çështjeje. Dhe, sikurse e thashë, ne kur të vijë
16 momenti i përshtatshëm do i japim shpjegimet e nevojshme
17 avokatëve. Megjithatë ne nuk pajtohemi me atë çfarë tha
18 avokati sa i takon trajtimit të informacionit në telefonin e
19 klientit të tij.

20 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

21 Avokat, e shoh që jeni ngritur në këmbë, e kam fjalën për
22 Avokatin Edwards. Po gjithashtu edhe z. Nilsson dëshiron që ta
23 marrë fjalën? Z. Nilsson, doni të shpjegoni diçka?

24 Z. NILSSON: [Përkthim] Vetëm shkurtimisht, Gjykatëse. Dua
25 thjesht që të sqaroj që, në qoftë se parashtrimi F88 i është

1 dërguar përmes postës elektronike sot në mëngjes, kështu më
2 thonë, domethënë, jo nuk është e nevojshme që të mbështeteni
3 te *Legal Workflow* si sistem sepse ky është një informacioni,
4 është një parashtrim që i është dërguar përmes postës
5 elektronike sot paradite, sikur thashë, e ka fjalën për
6 parashtrimin F88.

7 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Z. Edwards.

8 Z. EDWARDS: [Përkthim] Dua një përgjigje ndaj kolegut tim
9 nga ZPS-ja.

10 E nderuar Gjykatëse, arsyeja që pse kemi bërë parashtrime
11 që kemi bërë në paragrafët -- më lejoni një çast sa ta gjej,
12 pra, në parashtrimin tonë në paragrafin 17, ne kemi dhënë një
13 përgjigje të drejtpërdrejtë lidhur me mënyrën se si Prokuroria
14 i ka bërë parashtrimet e veta në paragrafin 9, ku Prokuroria
15 deklaroi që -- ky është një perifrazim i imi, domethënë,
16 ekipeve të Mbrojtjes do t'i jepet një softuer në mënyrë të
17 tillë që ata të kenë qasje në secilën prej pajisjeve
18 elektronike, në mënyrë të tillë që Mbrojtjet të kenë qasje dhe
19 të kryejnë kontrolle të plota në përmbajtjet e aparateve të
20 telefonave mobil.

21 Dhe në këtë kontekst, unë dua të them që përmbajtja e
22 plotë e aparatit të z. Kilaj ose aparateve të z. Kilaj i takon
23 që do jetë plotësisht e qasshme për ekipet e tjera të
24 mbrojtjes gjë të cilën neve e kundërshtojmë fuqimisht sepse ne
25 mendojmë që informacioni që nuk është relevant me këtë çështje

1 nuk duhet që të nxirret për Ekipet e tjetër të Mbrojtjes.

2 Megjithatë, megjithëse kolegu im më thotë që janë në
3 dijeni të detyrimeve të tyre dhe përcaktimi përkatës sa i
4 takon nxjerrjes së informacionit dhe jam i sigurtë që i dinë
5 detyrimet e tyre, megjithatë jam i sigurtë që kjo është një
6 çështje e cila do ngrihet. Dhe në qoftë se do ngrihet, ne do
7 ta trajtojmë shumë seriozisht.

8 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Ka ndonjë përgjigje?
9 Kundërpërgjigje? Diçka për të thënë?

10 Në rregull. Tani do të kalojmë tek pika 1(c) e rendit të
11 ditës. I kam kërkuar Zyrës Administrative që t'i përgjigjet
12 pyetjes në qoftë se shqyrtimet forensike të provave të
13 caktuara që janë transmetuar ose janë përcjellë për Zyrën
14 Administrative, pra, janë kërkuar ose janë sekuestruar dhe në
15 qoftë se një proces i tillë është në vazhdim e sipër, kështu
16 që dua të pyes se sa kohë do të duhet që të përfundojë analiza
17 e këtij materiali.

18 Atëherë dua që të bëj një përmbledhje të parashtimeve të
19 Zyrës Administrative që ka të bëjë kryesisht me z. Kuçi, do
20 mundohem që të jem sa më e përgjithshme që të jetë e mundur në
21 mënyrë të tillë që të mos nxjerrë informacion konfidencial
22 pasi jemi në seancë të hapur.

23 Zyra Administrative thotë që i ka dhënë disa dokumente
24 shkresore për institutin forensik dhe gjithashtu i ka dhënë
25 institutit në fjalë një listë përparësie sikurse është

1 propozuar nga ZPS-ja. Instituti forensik i jashtëm ka
2 informuar Zyrën Administrative dhe që duke marrë parasysh
3 ngarkesën e çështjes, do jap informacion sa i takon kohës që
4 nevojitet për përfundimi e analizës sa më shpejt të jetë e
5 mundur.

6 Analiza forensike e materialit të sekuestruar nga z. Kuçi
7 në një rast të mëparshëm është akoma në proces e sipër. Dhe
8 Zyra Administrative i ka kërkuar institutit në qoftë se mund
9 të ndihmonte në qoftë se ekzistonte një fjalëkalim ose një
10 fjalë kyçe për aparaturat e sekuestruara elektronike për
11 ekzekutimin e veprimeve ose aksione të kërkuara forensike.

12 Ndërkohë Zyra Administrative po ashtu ka përcjellë
13 informacion të mëtejshëm dhe pyetjet që kanë të bëjnë me
14 institutin forensik të jashtëm lidhur me mjetet që janë
15 sekuestruar nga z. Kuçi.

16 Ndërkohë që, së fundi, Zyra Administrative ka kërkuar
17 autorizim për të ndërlidhur me ZPS-në në qoftë se janë të
18 disponueshme fjalë kyçe për pajisjet elektronike dhe
19 sekuestruara nga z. Kuçi për të ndihmuar institutin forensik
20 për ekzekutimin e analizës forensike. Parashtrimet e Zyrës
21 Administrative, duke përfshirë këtu një listë të aparateve të
22 sekuestruar dhe numrat përkatës të identifikimit të tyre, së
23 bashku me zinxhirin e materialeve, i janë bërë të
24 disponueshme Mbrojtjes së z. Kuçi të premtën, më datë 13
25 dhjetor 2024, ndërkohë që këto janë informacione konfidenciale

1 dhe *ex parte*.

2 ZNJ. PRICE: [Përkthim] Ju kërkojmë ndjesë. Zyra
3 Administrative nuk ka asnjë kundërshtim që materialet *ex parte*
4 t'u vendosen në dispozicion të gjitha palëve, sidoqoftë mund
5 të vendosë Gjykatësja lidhur me këtë.

6 Kemi diçka për të shtuar për parashtrimet tona. E para
7 është që instituti kriminalistikës i ka thënë Zyrës
8 Administrative se po punojnë që ta përshpejtojnë sa më shumë
9 afatin dhe të na thonë sa më shpejt, mundësisht brenda kësaj
10 jave, se kur do ta përfundojnë analizën e tyre dhe ne do të
11 njoftojmë palët përkatësisht.

12 Gjithashtu sa i takon pikës së dytë, instituti i
13 kriminalistikës ka sqaruar në fakt se në qoftë se do të merrni
14 fjalëkalimin e z. Kuçi do të ishte një ndihmë e madhe.

15 Ne do të kontaktojmë ende lidhur me institutin e
16 kriminalistikës për çdo pyetje të mëtutjeshme që mund të ketë.

17 Faleminderit.

18 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

19 I drejtohem tashmë ZPS-së nëse ka parashtrime shtesë.

20 Gjithashtu do të doja që ZPS-ja të më konfirmonte nëse është
21 ende e gatshme të ofrojë asistencë dhe koment pyetjeve që ka
22 ngritur instituti i kriminalistikës i jashtëm dhe Zyra
23 Administrative në materialin konkret. Më konkretisht, a mund
24 të na thotë ZPS-ja nëse ka ndonjë fjalëkalim që mund ta
25 përshpejtojë analizën e materialeve provuese që i janë

1 sekuestruar siç e përmendi Zyra Administrative. Nëse po, ju
2 lutem ndajeni fjalëkalimet me Zyrën Administrative në mënyrë
3 që kjo e fundit t'ia japi institutit të kriminalistikës këto
4 fjalëkalime.

5 Z. HAFETZ: [Përkthim] E kuptoj. Ne, në fakt, kemi disa
6 fjalëkalime, do t'ia japim Zyrës Administrative në mënyrë që
7 Zyra Administrative t'ia japi institutit të kriminalistikës.
8 Ne kemi fjalëkalime për të paktën dy pajisje, do t'ua japim
9 sot.

10 Nuk kam gjë tjetër për të shtuar, ne jemi në dijeni të
11 listës me përparësitë përkatëse. Jemi të gatshëm të
12 komunikojmë me Zyrën Administrative që t'u përgjigjemi
13 pyetjeve që ka instituti i kriminalistikës. Po gjithashtu do
14 të dorëzojmë shumë shpejt dhe një kërkesë të mëtutjeshme për
15 ju, e nderuar Gjykatëse, sa i takon prioritizimit të
16 materialeve dhe pajisjeve që janë sekuestruar nga z. Kuçi e
17 veçanërisht parametrat specifik që janë kërkuar për analizën e
18 dokumentacionit në fjalë, të materialeve në fjalë desha të
19 thoja.

20 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

21 I drejtohem Mbrojtjes së z. Kuçi.

22 Mbrojtja ka ndonjë konstatim aktualisht? Më konkretisht
23 desha t'ju pyes, z. Kuçi, a pajtohet të komunikojë
24 fjalëkalimet e tij për pajisjet që janë sekuestruar për Zyrën
25 Administrative në mënyrë që t'i jepet mundësia institutit të

1 kriminalistikës që të bëjë një analizë sa më të shpejtë?

2 Z. Kuçi, theksoj se nuk jeni i detyruar ta bëni këtë, por
3 do të na ndihmonte shumë që të përshpejtonim procesin që vlen
4 edhe për ju në fakt.

5 Avokati Admiraal.

6 Z. ADMIRAAL: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Ne kemi
7 dhënë dy fjalëkalime, ia kemi dhënë ZPS-së. Nëse Zyra
8 Administrative apo ZPS-ja kanë nevojë për fjalëkalime të tjera
9 do ta diskutoj me klientin tim dhe di t'ju njoftoj.

10 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Ka diçka për të thënë
11 vetë z. Kuçi, dëshiron të thotë diçka z. Kuçi?

12 I AKUZUARI KUÇI: [Përmes videolidhjes] Faleminderit, znj.
13 Gjyqtare. Unë i kam dhënë fjalëkalimet që kanë kërkuar, po jam
14 i gatshëm të jap edhe për tjerat, për kompjuterin nëse a
15 fjala. Dhe nuk kam asgjë për të fshehur.

16 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, z. Kuçi. E
17 morëm parasysh. Atëherë ju lutem përmes avokatit tuaj
18 kontaktoni me Zyrën Administrative për ta realizuar këtë.

19 Tani, sa i takon ekipeve të Mbrojtjes më konkretisht,
20 Avokati Martens iu përgjigj një pjese të tyre. Unë ju pyeta
21 nëse aktualisht, pa cenuar të drejtat e të akuzuarve sipas
22 ligjit, a është një gjendje Mbrojtja të na thotë: Nëse do të
23 kryejë hetime dhe përafërsisht sa kohë do t'i nevojiten për të
24 kryer hetimet e veta, ka qenë pika 1(h) kjo, nëse do të
25 paraqesë ndonjë arsye për përjashtimin e përgjegjësisë penale,

1 pika 1(i) dhe nëse synon të paraqesë mocione paraprake, pika
2 1(j).

3 Do të përmbledh shkurtimisht parashtrimet me shkrim që
4 kanë dhënë z. Thaçi dhe z. Kilaj përmes Mbrojtjes së tyre.

5 Si Mbrojtja e z. Thaçi dhe z. Kilaj parashtrojnë se nuk
6 janë ende në pozicion për të dhënë parashtrime aktualisht sa i
7 takon hetimeve që do të kryejë Mbrojtja sidomos duke marrë
8 parasysh që nuk është marrë asnjë material në lidhje me këtë,
9 por që rezervojnë të drejtën e tyre për të paraqitur arsye për
10 përjashtimin e përgjegjësisë penale në një fazë të mëvonshme
11 dhe duke mos pasur asnjë material të rregulle 102(1)(a), z.
12 Thaçi dhe z. Kilaj rezervojnë të drejtën e tyre për të
13 dorëzuar mocione paraprake.

14 Ju rikujtoj edhe një herë që nuk pres aktualisht që
15 Mbrojtja të bëjë parashtrime të formës së prerë lidhur me këto
16 pika aktualisht. Gjithashtu, ju rikujtoj se procesi i
17 nxjerrjes së materialeve është duke filluar dhe se mocionet
18 paraprake mund të dorëzohen brenda 30 ditësh nga nxjerrja e të
19 gjitha materialeve që përmenden në rregullën 102(1)(a) të
20 Rregullores.

21 Avokatja Menegon, a keni diçka për të thënë lidhur me
22 parashtrimet me shkrim që keni bërë në emër të z. Thaçi?

23 ZNJ. MENEGON: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Jo, nuk
24 kam asgjë. Ne jemi ende duke pritur për materialet që
25 mbështesin fletë-arrestimin. Kaq. Faleminderit.

1 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

2 Mbrojtja e z. Smakaj për të njëjtën pikë. A iu bashkoheni
3 parashtrimeve që ka bërë avokati i z. Thaçi dhe z. Kilaj apo
4 kemi diçka më shumë për të thënë?

5 Z. MARTENS: [Përkthim] Bashkohem me parafolësit. Dhe
6 sikurse ju thashë në fjalën që mbajta më herët, ne jemi ende
7 duke pritur të shohim çfarë provash do të na japin dhe më pas
8 do të rezervojmë qëndrimin tonë. Faleminderit.

9 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

10 Mbrojtja e z. Fazliu e njëjta pyetje dhe për ju. Avokati
11 Pestman fjala është për ju.

12 Z. PESTMAN: [Përkthim] Faleminderit. Mbase nuk do të jetë
13 befasi për ju në qoftë se unë ju them që për ne është e
14 parakohshme t'i përgjigjemi këtyre pyetjeve. Nuk kemi mundësi
15 t'u përgjigjemi se ende nuk janë nxjerrë materialet. Kështu që
16 rezervojmë të drejtën tonë për dorëzimin e mocioneve paraprahe
17 brenda afateve që parashikon Rregullorja.

18 Gjithashtu vërej se Prokurori nuk është ende përgjigjur
19 pyetjes sime për dëshmitarët. Unë bëra një pyetje për
20 dëshmitarët në fakt që lidhej me pyetjen tuaj (f), paragrafi
21 11 i parashtrimeve të Prokurorisë.

22 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit. Do t'ia
23 japim fjalën pas një çasti Prokurorit në mënyrë që të
24 përgjigjet.

25 Tani i drejtohem avokatit të z. Kuçi. A u bashkoheni

1 parashtrimeve që kanë bërë ekipet e Mbrojtjes së z. Thaçi, z.
2 Kilaj, apo keni diçka për të shtuar?

3 Z. ADMIRAAL: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] U
4 bashkohemi parashtrimeve. Nuk kemi asgjë për të thënë as ne.
5 Dhe ne jemi duke pritur të dalin materialet përkatëse.

6 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

7 Dhe në fund, Mbrojtja e z. Kilaj, e njëjta pyetje dhe për
8 ju, z. Edwards.

9 Z. EDWARDS: [Përkthim] Ne e kemi bërë të qartë pozicionin
10 tonë në parashtrimin përkatës.

11 Megjithatë do të doja të thoja diçka, se ju po flisni për
12 parashtrimet e Mbrojtjes dhe i kaluat shumë shpejt pikat tona.
13 Më duhet të them që unë stresohem pak, u stresova pak kur
14 dëgjova që ka bërë parashtrime Zyra Administrative, pra,
15 parashtrime që lidhen me konferencën e ditës së sotme. Mendova
16 se mos më kishte shpëtuar mua. Po, në fakt, jo, sepse këto
17 janë dorëzuar *ex parte*.

18 Pra, ju keni para jush parashtrime, parashtrime që i ka
19 parë dhe ZPS-ja që burojnë nga Zyra Administrative dhe mesa
20 kuptoj unë kjo lidhet kryesisht me z. Kuçi. Sidoqoftë ne nuk e
21 dimë çfarë ka thënë Zyra Administrative, cilat janë
22 parashtrimet që ka dhënë për ditën e sotme. Është qetësuese
23 fillimisht që janë dorëzuar *ex parte*, veçanërisht, mesa kuptoj
24 unë nuk kanë pse të jenë *ex parte*. Ekipet e Mbrojtjes duhet
25 t'i kishin lexuar këto parashtrime.

Unë nuk dua që në seancën e sotme të çojmë kohën dëm, por, e nderuar Gjykatëse, do të ishte mirë që dhe ne t'i shihnim këto parashtime të riklasifikuara nga Zyra Administrative dhe mund të kemi dhe ne më pas parashtime me shkrim në lidhje me këto. Po nga ana jonë jemi komplet, jemi qorrazi s'e kemi idenë çfarë po ndodh, fatkeqësisht kjo është situata, më vjen keq që e mësova sot në mes të seancës.

GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] E morëm parasysh Avokati Edwards. Do të flasim dhe për riklasifikimin por drejt fundit të seancës. Por, në fakt, meqë ju e ngritët, unë dua t'ju them që unë jam aktualisht duke u marrë me procesin e riklasifikimit në mënyrë që ju, në fakt, të gjitha Ekipet e Mbrojtjes në kohën e duhur të merrni të gjitha parashtimet që ekzistojnë për këtë lëndë gjyqësore. Po do flasim sërish për këtë.

Në rregull. Faleminderit Ekipet e Mbrojtjes për parashtimet e tyre qëndrimet tuaja janë marrë të gjitha parasysh.

Flasim tani në pikën e dytë në rendin e ditës, materialet mbështetëse të aktakuzës dhe rregulla 86(3)(b).

I kam kërkuar ZPS-së të na japi informacione specifike fillimisht: një, për vëllimin e materialit sipas rregullës 102(1))(a) të zbërthyer dhe përkthimin e këtyre materialeve, janë pika 2(a) dhe (b); nëse materialet sipas rregullës 102(1)(a) dhe tabela përkatëse kanë nevojë për redaktime është

1 pika 2(c)]; dhe, tre, nëse është në gjendje ZPS-ja t'i nxjerrë
2 këto materiale sa më shpejt pas konferencës së ditës së sotme,
3 por sidoqoftë brenda afatit 30 ditor që parashihet në
4 rregullën 102(1)(a), gjegjësisht brenda 7 janarit 2025, është
5 pika 2(d) e rendit të ditës.

6 Unë do të bëj një përmbledhje të shkurtër të
7 parashtrimeve që ka bërë ZPS-ja me shkrim dhe ku ka thënë se:
8 ZPS-ja ka dhënë një zbërthim të materialit të rregullës
9 102(1)(a). Po ashtu është shprehur se ka marrë një deklaratë
10 nga z. Kilaj më 2 nëntor 2023, e cila është në anglisht dhe në
11 shqip dhe është pjesë e rregullës 102(1)(a) dhe një kopje i
12 është dhënë Avokatit të z. Kilaj në prill 2024, pra, një kopje
13 e kësaj deklarate.

14 Deklaratat e dëshmitarit janë përkthyer në gjuhën shqipe.

15 Lidhur me këto dy parashtrime të ZPS-së, unë kam marrë
16 parasysh kërkesën e z. Kilaj për një sqarim për sa i përket
17 numrave që ka dhënë ZPS-ja në tabelën përkatëse.

18 Tani disa nga materialet e rregullës 102(1)(a) sidoqoftë
19 kanë nevojë për redakte. Sidoqoftë tabela e detajuar që
20 është dorëzuar nga ZPS-ja në aktakuzën përkatëse mund t'i
21 jepet menjëherë ekipeve të Mbrojtjes, por në mënyrë
22 konfidenciale.

23 Së fundi, ZPS-ja është e përgatitur të nxjerrë të gjitha
24 materialet që janë objekt i rregullës 102(1)(a) që nuk kanë
25 nevojë për redakte menjëherë pasi të përfundojë seanca e

1 ditës së sotme. Po ashtu ZPS-ja është e përgatitur të nxjerrë
2 materialët e mbetura të rregullës 102(1)(a) që kanë nevojë për
3 redaktime në vijim të vendimit të Gjykatës së Procedurës
4 Paraprake sa i takon protokollit për nxjerrjen e materialeve.

5 Përpara se t'i jap fjalën ZPS-së, dëshiroj të përsëris se
6 ZPS-ja duhet të nxjerrë tërësinë e materialeve që janë objekt
7 i rregullës 102(1)(a) sa më shpejt dhe jo më vonë se 30 ditë
8 pas paraqitjes së parë të akuzuarve që u mbajt më 8 dhe 9
9 dhjetor 2024. Gjithashtu dëshiroj të përsëris edhe një herë që
10 synoj të nxjerr Vendimin Kornizë me nxjerrjen e provave
11 përfshirë sistemin e redaktimeve brenda fundit të kësaj jave.

12 Sa i takon materialeve të rregullës 86(3)(b), do ta
13 riklasifikoj shkurtimisht si konfidencial sepse mund të ndahet
14 me Ekipet e Mbrojtjes pa redaktime.

15 Më tej, më lejoni të përfshij në parashtimet tua, z.
16 Prokuror, disa sqarime sa i takon numrave që keni dhënë në
17 parashtimet tua, më konkretisht në paragrafin 13.

18 Së pari, ju keni thënë se do të mbështeteni në një
19 dëshmitar për këtë Aktakuzë, por sërish keni thënë se do të
20 jepni katër deklaratat dëshmitarësh në anglisht dhe në shqip.
21 Është tabela A, rreshti 3 në krye. Këto deklaratat i referohen
22 një dëshmitari apo dy dëshmitarëve, siç shpreheni ju në
23 paragrafin 15 të parashtimeve tua?

24 Së dyti, a mund të na sqaroni edhe një herë, meqë është
25 kërkuar dhe Mbrojtja e z. Kilaj, nëse deklaratat që mbështesin

1 aktakuzën i implikojnë të pestë të akuzuarit apo vetëm disa
2 prej tyre?

3 Së treti, e kam kuptuar unë drejt që Avokati Edwards ka
4 marrë një kopje të versionit në anglisht të deklaratës së z.
5 Kilaj që është marrë më 2 nëntor 2023? Po z. Kilaj a e ka
6 marrë versionin në gjuhën shqipe të kësaj deklarate? I
7 referohem poshtëshënimit 2.

8 Krahës kësaj, vërej se ZPS-ja sot paradite ka dorëzuar
9 një kërkesë për masa mbrojtëse lidhur me materialet e
10 rregullës 102(1)(a) - parashtimi mban numrin F87 - dhe i
11 klasifikuar si rreptësishtë konfidencial dhe *ex parte*. Në
12 kërkesë ka po ashtu parashtime për protokollin që do të
13 trajtohet për informacionin konfidencial dhe kontaktimin e
14 dëshmitarëve dhe viktimave.

15 Për momentin do të fokusohem vetëm në masat mbrojtëse që
16 janë kërkuar nga ZPS-ja.

17 Kuptoj që në kërkesë ZPS-ja, pra, me numër F87, nuk janë
18 kërkuar masa mbrojtëse për Mbrojtjen por për publikun. Kjo do
19 të thotë se nxjerrja e materialeve që mbështesin Aktakuzën
20 mund të dorëzohet brenda afateve të parapara pa autorizim të
21 mëtutjeshëm dhe sigurisht në varësi të Vendimit Kornizë për
22 nxjerrjen e materialeve. Do lutesha që ZPS-ja të na thotë
23 diçka lidhur me këtë.

24 Gjithashtu, mesa kuptoj ju synoni të dorëzoni një version
25 të redaktuar konfidencial. Kur do ta bëni këtë?

1 Do t'ia jap fjalën Prokurorisë që të japë përgjigje dhe
2 sqarime siç u kërkuan.

3 Z. Prokuror, fjala është për ju.

4 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit. Po filloj me
5 pyetjen e fundit për masat mbrojtëse. Po, është e vërtetë, e
6 keni kuptuar shumë drejt. Dokumentet mund të nxirren pa
7 redakte për Ekipet e Mbrojtjes.

8 Sa i takon versionit konfidencial të mocionit në fjalë,
9 ne do të nxjerrim -- do ta nxjerrim këtë mocion shumë shpejt,
10 brenda kësaj jave mendojmë që do ta dorëzojmë këtë material.

11 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Pra, brenda kësaj jave po
12 thoni?

13 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Po, brenda kësaj jave do ta
14 nxjerrim mocionin me redaktimet përkatëse.

15 Lidhur me materialet e rregullës 102(1)(a), kemi disa
16 parashtime. E para ka të bëjë me kërkesën që bëri avokati i
17 z. Kilaj në parashtimin 21 me numër F83 të cilin ju sapo e
18 përmbloodhët në fakt para një çasti. ZPS-ja sqaron se për hir
19 të Aktakuzës së Konfirmuar është mbështetur në deklaratat e
20 një dëshmitari. Janë dy deklarata që burojnë nga i njëjti
21 dëshmitar dhe paketa përfshin shqipen, pra, përkthimin në
22 gjuhën shqipe të këtyre deklaratave, prandaj duket sikur ka më
23 shumë materiale prandaj janë katër materiale në tabelën
24 përkatëse.

25 Gjithashtu dua ta sqaroj edhe këtë për avokatin sepse

1 është një pikë që është ngritur më herët, deklaratat janë
2 relevante për të gjitha akuzat dhe për të gjithë të akuzuarit
3 në këtë lëndë gjyqësore dhe kjo vlen dhe për dëshmitarët e
4 tjerë që synon që të thërrasë Prokuroria për të dhënë dëshmi
5 në këtë gjyq.

6 Sa i takon nxjerrjes së materialeve që mbështesin
7 aktakuzën aktualisht, ne po bëjmë verifikimet e fundit të
8 paketës dhe mendojmë se do t'i nxjerrim materialet të
9 paredaktuara që janë pjesë e rregulle 102(1)(a) brenda ditës
10 së nesërme.

11 Gjithashtu do t'ua japim në formë të zbërthyer materialet
12 që kemi, nga 185 materiale që janë pjesë e rregullës
13 102(1)(a), 123 materiale do të nxirren pa redakte. Pra, siç
14 ua thashë brenda ditës së nesërme. Pjesa e mbetur e
15 materialeve, që i takon 62 materiale të tjera, kanë nevojë për
16 disa redakte të vogla standarde që do të kryhen në përputhje
17 me vendimin që do të nxirrni ju për nxjerrjen e materialeve.

18 Kaq kishte nga ana jonë. Faleminderit.

19 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Tani i drejtohem
20 Mbrojtjes dhe do të kërkoj prej tyre parashtrime të shkurtra
21 dhe të qarta, do të fillojmë me Mbrojtjen e z. Thaçi.

22 ZNJ. MENEGON: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Nuk kam
23 kurrfarë komenti, e nderuar Gjykatëse.

24 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, znj.
25 Menegon.

1 Z. Martens.

2 Z. MARTENS: [Përkthim] Nuk kam komente në këtë moment.

3 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

4 Z. Pestman, ju e keni radhën.

5 Z. PESTMAN: [Përkthim] Nuk kam as unë komente.

6 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, avokat.

7 Z. Admiraal, e keni fjalën.

8 Z. ADMIRAAL: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Më falni,

9 nuk ju dëgjova, e nderuar Gjykatëse. Nuk kam komente.

10 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

11 Z. Edwards.

12 Z. EDWARDS: [Përkthim] Z. Kilaj, tani është vendosur nga

13 i treti me radhë në Aktakuzë në të pestin. Nuk e di në qoftë

14 se kjo është bërë vetëm për qëllimet e kësaj seance.

15 Sidoqoftë, kërkoj sqarim për një pikë dhe mendoj që kjo

16 është publike. Prokuroria në paragrafin 11 të parashtimeve të

17 veta me shkrim thotë se presin apo planifikojnë të paraqesin

18 dëshmitë e tre dëshmitarëve në gjykim. Domethënë, supozojmë që

19 ky është dëshmitari mbi të cilin mbështeten Aktakuza dhe dy

20 dëshmitarë të tjerë.

21 Pastaj në paragrafin 20, Prokuroria thekson se pret që të

22 marrë deklaratë dhe prej disa dëshmitarëve të tjerë. A është

23 kjo thjesht një planifikim prej anës së tyre apo është një

24 realitet për sa i përket numrit të dëshmitarëve mbi të cilët

25 do të mbështetet Prokuroria? Sa deklarata janë marrë realisht,

1 sa prej tyre dhe kur mund të nxirren për Mbrojtjen? Dhe ka
2 ndonjë arsye sepse ato nuk mund të nxirren në qoftë se nuk
3 mund të nxirren?

4 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

5 Znj. Prokurore apo ju, z. Prokuror, do të përgjigjeni.

6 Z. HAFETZ: [Përkthim] Do të përgjigjem unë, e nderuar
7 Gjykatëse.

8 Po thuhet se të paktën tre dhe është e vërtetë që ne
9 synojmë të thërrasim tre dëshmitarë të paktën, duke përfshirë
10 atë që është i përmendur me emër apo që mbi të cilën është
11 mbështetë dokumentacioni mbështetës i aktakuzës. Për sa i
12 përket deklaratave prej këtij dëshmitari, kolegja ime
13 përshkroi procesin e nxjerrjes së atyre deklaratave në bazë të
14 rregullës 102(1)(a).

15 Si kemi theksuar edhe në paragrafin 20 disa që do të
16 thotë dy apo më shumë që ne presim, domethënë, prej kujt ne
17 presim të marrim deklaratat, mund të mirren deklaratat të tilla.
18 Mirëpo ne do t'i nxjerrim ato deklaratat për Mbrojtjen në
19 mënyrë progresive, në përputhje me rregullat dhe ashtu siç
20 parashikohet në to.

21 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Vetëm desha të më
22 përgjigjeni në pyetjen që bëra paraprkisht në qoftë se z.
23 Kilaj ka marrë versionin në shqip të deklaratës.

24 Z. HAFETZ: [Përkthim] Po, kërkoj ndjesë që nuk u
25 përgjigja në atë pyetje. Gjatë takimeve *inter partes* të vitit

1 të shkuar, ne kemi shkëmbyer disa pyetje dhe përgjigje me
2 Mbrojtjen e z. Kilaj. Unë nuk e kam përgjigjen he për he, po
3 do ta kontrolloj këtë me ekipin tim dhe do t'ju përgjigjem më
4 pas, por i kemi dhënë kopje të intervistës, faktikisht të
5 incizimit të vet intervistës. Këtë mund ta konfirmoj.

6 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

7 Z. EDWARDS: [Përkthim] Unë mund të ndihmoj në këtë
8 drejtim, e nderuar Gjykatëse. Ne jemi në gjendje të
9 përgjigjemi, po, kemi marrë transkriptin e asaj deklarate në
10 shqip dhe anglisht.

11 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, z. Edwards.

12 Tani do të jap disa vendime me gojë.

13 Vendimi i parë me gojë ka të bëjë me riklasifikimin e
14 përmbledhjes sipas rregullës 86(3)(b).

15 Pas kërkesës së ZPS-së, unë udhëzoj Zyrën Administrative
16 që përmbledhjen që është parashtrimi F00028, aktualisht e
17 klasifikuar si rreptësishtë konfidenciale dhe *ex parte*, t'i
18 hiqet shënimi *ex parte* dhe të riklasifikohet si konfidenciale
19 në përputhje me rregullën 82(5) të Rregullores.

20 Këtu përfundon urdhri i parë gojor.

21 Urdhri i dytë ka të bëjë me nxjerrjen e materialit të
22 rregullës 102(1)(a) që nuk ka nevojë për redakte.

23 Pasi i kam dëgjuar parashtrimet e palëve dhe veçanërisht
24 të ZPS-së se mund menjëherë të vazhdojë me nxjerrjen e
25 materialeve që nuk kanë nevojë për redakte, udhëzoj ZPS-në

1 që të vijojë me nxjerrjen e këtij materiali menjëherë pas
2 seancës sotme. Materialet e tjera që kërkojnë redaktime do të
3 nxirren në pajtim me Vendimin Kornizë për nxjerrjen e
4 materialeve.

5 Sidoqoftë, ZPS-ja duhet të përfundojë procesin e
6 nxjerrjes së materialeve të rregullës 102(1)(a) deri më 7
7 janar 2025.

8 Këtu përfundon urdhri i dytë gojor.

9 Dhe sa i përket urdhrit të tretë gojor, ka të bëjë me
10 parashtrimin prej Prokurorisë të versionit konfidencial dhe të
11 redaktuar të F87.

12 Udhëzoj ZPS-në që këto versione t'i dorëzojë për
13 protokollim deri më së voni të enjten, më 19 dhjetor 2024.

14 Këtu përfundon urdhri im i tretë gojor.

15 Dhe kalojmë tani tek pika 3 e rendit të ditës,
16 përkatësisht materialet shtesë që ZPS-ja synon t'i përdorë
17 gjatë gjykimit.

18 I kam kërkuar ZPS-së që të shprehet në qoftë se do të
19 përdorë dhe do të mbështetet në materialin 102(10)(b), së
20 bashku me kategorizimin e këtij materiali, pika 3(a) dhe
21 numrin e përafërt të këtyre materialeve dhe llojin e tyre në
22 qoftë se ato kanë nevojë për redaktime, pika 3(c), kur ZPS-ja
23 pritet të jetë e gatshme të bëjë nxjerrjen e këtij materiali,
24 pika 3(d) dhe, në qoftë se ZPS-ja mund ta nxjerrë këtë
25 material dhe përkthimet përkatëse në lidhje me deklaratat e

1 dëshmitarëve në të njëjtën paketë të materialeve, pika 3(e).

2 Theksoj se, në parashtimet e veta, ZPS-ja propozon që të
3 nxjerrë material shtesë të rregullës 102(1)(b) në mënyrë
4 progresive duke filluar nga 20 dhjetori 2024 dhe se synon të
5 nxjerrë materialet të tjera, si do që të jetë, jo më vonë se
6 30 ditë pas hapjes së paraqitjes së provave të ZPS-së.

7 Provat që do të nxirren duke fillua nga data 20 dhjetor
8 2024 do të përfshijnë kopjet forensike dhe raportet e
9 gjeneruara me programin *Cellebrite* për më shumë telefon
10 celular si dhe dosjet me zë dhe incizimet me zë të vizitave jo
11 të privilegjuara në qendrën e paraburgimit që përmenden në
12 Aktakuzën e Konfirmuar.

13 ZPS-ja më tej parashtroi se pret që të marrë deklaratat
14 nga disa dëshmitarë të cilët do të nxirren në anglisht dhe në
15 shqipe, transkripte shtesë material audio-vizual si dhe një
16 raport eksperti.

17 ZPS-ja pretendon se nuk mund të japë parashikime kohore
18 për sa i përket nxjerrjes së materialeve sipas rregullës
19 102(1)(b) dhe kur do të përfundojë nxjerrja e këtyre
20 materialeve. Megjithatë, parashtroi se pothuajse të gjithë
21 materialin do ta nxjerrë të rregullës 102(1)(a), si dhe provat
22 shoqëruese, ku përfshihen të dhënat e thirrjeve, të dhënat nga
23 telefonat e sekuestruar, materialet audio-vizuale duke përfshi
24 incizimet zanore të vizitave jo të privilegjuara në qendrën e
25 paraburgimit me z. Thaçi, dokumentacionin e mbledhur nga këto

1 telefona mobil, pastaj, objekte fizike duke përfshi dokumente
2 të marra gjatë kontrollimit dhe sekuestrimit, shënime zyrtare
3 të marra nga qendra e paraburgimit të DHSK-së ku konfirmohen
4 data, koha dhe pjesëmarrësit në atë vizita, pra, jo të
5 privilegjuara.

6 ZPS-ja gjithashtu parashtroi se disa nga këto materiale
7 të rregullës 101(2)(b) mund të kërkojnë redaktime.

8 Gjithashtu, propozon që të nxirren materialet e rregullës
9 102(1)(b) jo më vonë se 30 ditë para hapjes së paraqitjes së
10 provave të ZPS-së.

11 Dhe, së fundi, ZPS-ja angazhohet që të nxjerrë gjithë
12 materialin e përmendur njëkohësisht me të gjitha deklaratat e
13 dëshmitarëve, si dhe t'i nxjerrë ato deklaratat dëshmitarëve
14 dhe përkthimet e tyre në të njëjtën paketë të materialeve të
15 nxjerra.

16 Theksoj gjithashtu parashtrimet e z. Kilaj, të Mbrojtjes
17 së z. Kilaj se në lidhje me materialet e rregullës 102(1)(b)
18 nxjerrja është brenda diskrecionit të Gjykatës së Procedurës
19 së Paraprake, por se materiali i tillë duhet të dorëzohet më
20 së paku 30 ditë përpara hapjes së çështjes së Prokurorisë.

21 Tani ftoj ZPS-në që të bëjë parashtrime shtesë në lidhje
22 me:

23 Një, a mund ZPS-ja sot të japë një datë të përafërt - më
24 falni - një numër të përafërt të materialeve dhe llojin e tyre
25 që do t'i nxjerrë?

1 E dyta, në qoftë se ZPS-ja mund sot të na tregojë sesa
2 prej këtyre materialeve të rregullës 102(1)(b) do të duhet të
3 redaktohen.

4 Dhe, e treta, në qoftë se mund të është e gatshme që të
5 përfundojë nxjerrjen brenda fazës së paraprase, pavarësisht,
6 rregullës 102(2) dhe rregullës 118(2)? Në qoftë se nxjerrja e
7 materialeve brenda 28 marsit 2025 ose 30 prillit 2025 është
8 një datë reale për njoftimin e parë materialëve të rregullës
9 102(3) e propozuar që të parashtrohen deri më 17 shkurt 2025?

10 Dhe, së katërti, nëse ka të dhëna të tjera shtesë që ZPS-
11 ja do t'i shtyjë në lidhje me kategoritë e provave të veta.

12 Urdhëroni, z. Prokuror.

13 Z. HAFETZ: [Përkthim] Sot do të mbështetem vetëm në ato
14 që i kemi thënë me shkrim sa u përket datave ka, siç thashë,
15 një numër pajisjesh që janë marrë, duhet të bëhen disa analiza
16 dhe madje dhe kur të kryhen ato analiza një pjesë e atij
17 materiali të analizuar mund të jetë objekt i një rishikimi
18 prej një pale tjetër në mënyrë që materiali i privilegjuar të
19 mund të kalohet i tëri.

20 Sikurse kam theksuar edhe më herët, pothuajse i gjithë
21 materiali që është i rregullës 102(1)(a) do të përdoren si
22 prova materiale gjatë gjyqimit dhe kjo është pjesa më e madhe
23 apo e konsiderueshme e provave që do t'i përdorë ZPS-ja gjatë
24 gjyqimit. Dhe nuk është sekret që pjesa më e madhe e çështjes
25 sonë e provave tona bazohen në këto materiale.

1 Gjithashtu theksoj, jam konsultuar dhe kam biseduar me
2 avokatët e Mbrojtjes përpara seancës së sotme. Regjistrimet me
3 zë të marra nga qendra e paraburgimit do të nxirret nga
4 pajisjet e jashtme sepse kjo është mënyra sesi i ka marrë dhe
5 ZPS-ja dhe është formati në të cilin i kemi marrë.

6 Ne do t'ju japim atyre një kopje, gjithashtu edhe Zyrës
7 për Administrimin Gjyqësor nga një kopje të tillë deri të
8 premtën. Ne do të kemi njerëz edhe gjatë pushimit të Gjykatës
9 që të mund t'i marrë këto.

10 Për sa u përket nxjerrjeve që lidhen me telefonat sipas
11 rregullës 102(1)(b), ne nuk mund të konfirmojmë asnjë gjë për
12 momentin. Ne duhet të konsultohemi me palët *inter partes*
13 përpara se t'ju drejtohem atyre në lidhje me telefonat e
14 marrë prej klientëve të tyre.

15 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, z.
16 Prokuror.

17 Tani do t'ju drejtohem avokatëve mbrojtës në qoftë se
18 kanë parashtime.

19 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Nuk kam ndonjë gjë konkrete. Por
20 thjesht dua të konfirmoj se çojmë gatishmërinë e ZPS-së për
21 nxjerrjen e deklaratave dhe provave shoqëruese, sepse kjo do
22 të ndihmojë në kryerjen e shpejtë të procedurave.

23 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
24 Avokate.

25 Z. Martens.

1 Z. MARTENS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.
2 Në fjalën hyrëse dhashë parashtimet e mia në lidhje me provat
3 e rregullës 102(1) (b). Por ajo që përsëritet në kokën time
4 është si vijon: A është duke thënë ZPS-ja se vazhdon puna në
5 lidhje me këto prova dhe ato nuk mund të nxirren për shkak të
6 problemeve logjistike apo është kjo pjesë e strategjisë së
7 ZPS-së për të mos nxjerrë informacionin për arsye se, për
8 shembull, i akuzuari duhet të konfrontohet në një intervistë
9 apo në një gjë të ngjashme?

10 Unë theksoj edhe një herë se kjo çështje është zhvilluar
11 në fazë *ex parte* për një kohë të gjatë. Dhe parashtroj se çdo
12 provë që është e gatshme për dorëzim dhe që për të cilën nuk
13 duhet të ndonjë gjë tjetër nga aspekti logjistikë, mund të
14 nxirret sa më shpejt që është e mundur dhe atë më herët se
15 data përfundimtare e marsit 2025. Unë mendoj se të gjitha
16 provat e Prokurorisë simbas rregullës 102(10(a)) mund të
17 nxirren edhe në një datë më të hershme.

18 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, z. Martens.

19 Z. Pestman, ju e keni radhën.

20 Z. PESTMAN: [Përkthim] Faleminderit. Kam një pyetje për
21 Prokurorin ose Prokuroren. Klienti im flet vetëm shqip, nuk e
22 flet dhe lexon anglishten ose ndonjë gjuhë tjetër zyrtare të
23 kësaj Gjykate. Pyetja ime është kjo: A do të dorëzohen edhe
24 përkthimet në gjuhën shqipe të këtyre dokumenteve
25 njëkohësisht, pra, dokumenteve origjinale?

1 Do ta çmoj në qoftë se përkthimet dorëzohen në të njëjtën
2 kohë dhe jo në momente të mëpasshme gjatë procedurës. Kjo
3 ishte e vetmja që desha të them.

4 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

5 Do t'i jap fjalën Prokurorit që të përgjigjet edhe në
6 pyetjen që parashtroj z. Martens. Mirëpo, përpara se ata bëj
7 këtë fjalën e ka z. Admiraal.

8 Z. ADMIRAAL: [Përkthim] Nuk kam asnjë gjë për të shtuar.

9 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

10 Z. Edwards.

11 Z. EDWARDS: [Përkthim] Një sqarim dhe një koment, në
12 paragrafin 22 ku themi se nxjerrja për Mbrojtjen e materialeve
13 është brenda të drejtës diskrecionale të Gjykatës së
14 Procedurës Paraprake.

15 Dhe, e dyta, përpara hapjes së fazës së paraqitjes së
16 provave prej Prokurorisë, mesa kuptoj unë, materiali duhet të
17 nxirret më së voni 30 ditë para hapjes së çështjes Prokurorisë
18 sipas rregullës 102(10(b), sa më shumë që i afrohem atij
19 afati 30 ditor, aq më e gjasshme është që materialet që do t'i
20 nxirren Mbrojtjes të jenë më voluminoze, domethënë, të jenë më
21 shumë materiale dhe kjo të vështirësojë përgatitjet e
22 Mbrojtjes. Prandaj i kërkojmë Gjykatës së Procedurës
23 Paraprake dhe Prokurorisë që ta kryejnë procesin e nxjerrjes
24 së materialeve shumë më përpara atij afati prej 30 ditësh.

25 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, z. Edwards.

1 Tani e ka fjalën Prokurori, keni parasysh se keni pyetje
2 prej z. Martens, prej z. Pestman dhe prej z. Edwards.
3 Urdhëroni.

4 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse. Sa i
5 takon përkthimeve, përkthimet do të jepen në pajtim me
6 rregulloren. Pra, do jepen sipas rregullës 102(1)(a), janë
7 materiale të cilat janë në mënyrë të vazhdueshme të
8 disponueshme, ndërkohë që sa i takon deklaratave të
9 dëshmitarëve sipas rregullës 102(1)(b) edhe ato do të jepen në
10 të njëjtën kohë.

11 Nuk e di në qoftë se i trajtova të gjitha pyetjet që m'u
12 drejtuan.

13 Edhe, një herë, dua që të referohem parashtimeve që kemi
14 dhënë dhe më herët lidhur me nxjerrjen e materialeve, të
15 gjitha materialeve. Sikurse e kemi thënë dhe disa herë të
16 tjera, ne do i nxjerrim materialet në mënyrë graduale sa më
17 shpejtë të jetë të mundur, ndërkohë që koha konkrete do të
18 varet nga redaktimet, nga aspektet teknike, nga çështje
19 logjistike dhe nuk do të bëhen në këtë fazë të procesit
20 gjyqësor.

21 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull.

22 Tani do të jap urdhrin e katërt gojor sa i takon
23 materialit që do të nxirren sipas rregullës 102(1)(b) që nuk
24 kërkon që të redaktohet, nuk është e nevojshme të redaktohet.

25 Sikurse është përcaktuar në Vendimin Kornizë, ZPS-ja

1 është udhëzuar që të fillojë me nxjerrjen e materialeve sipas
2 rregullës 102(1)(b) që nuk është e nevojshme që t'i
3 nënshtrohet redaktimeve dhe këto materiale të nxirren sa më
4 shpejt të jetë e mundur. Afati për nxjerrjen e materialeve të
5 mbetura do të përcaktohet në Vendimin e radhës Kuadër.

6 Ky është urdhri i tretë gojor i imi.

7 Ndërkohë që tani do të vazhdoj me elementin e tjerë ose
8 aspektin e tjerë në rendin e ditës që ka të bëjë me materialet
9 që janë të rëndësishme për përgatitjen e Mbrojtjes që është
10 material sipas rregullës 102(1)(b).

11 I kërkoj ZPS-së, në qoftë se ZPS-ja ka në zotërimin e vet
12 ndonjë material që bie nën këtë rregull, domethënë, që është
13 pika 4(a), po ashtu do i kërkoja ZPS-së që të thojë se cili
14 është lloji dhe volumi që mendohet i këtij materiali, pra, që
15 është pika 4(b), po ashtu i kërkoj ZPS-së që të shprehet në
16 qoftë se materiali kërkon redaktime, pika 4(c) dhe, katër, kur
17 ZPS-ja mund të njoftojë Mbrojtjen, kjo është pika 4(d) në
18 rendin e ditës.

19 Përsëri do bëj një përshkrim të shkurtër të parashtrimeve
20 të ZPS-së në këtë aspekt.

21 ZPS-ja e informon Mbrojtjen dhe Trupin Gjykses që ka në
22 posedim materiale dhe materialet do t'i nxjerrë pasi rregulla
23 -- materialet sipas rregullës 102(1)(b) dhe dokumente
24 potencialisht shfajësuese do të nxirren. Po ashtu ZPS-ja shton
25 që fushëveprimi i materialit është i domosdoshëm dhe, në qoftë

1 se bëhet fjalë për një volum të konsiderueshëm, atëherë do i
2 drejtohet palëve. Kështu që për këtë arsye ZPS-ja nuk është se
3 ka dhënë ndonjë volum të përafërt të materialeve.

4 Po ashtu ZPS-ja parashtrohet më tej që një pjesë e
5 dokumenteve sipas rregullit 102(3) kanë nevojë për redaktim.

6 Dhe ZPS-ja thotë po ashtu që disa prej materialeve 102(3)
7 mund të dorëzohen -- janë dorëzuar më datë 17 shkurt -- mund
8 të dorëzohen më datë 17 shkurt 2025 dhe pjesa tjetër e
9 materialeve do të jepen në mënyrë graduale.

10 Së fundi, ZPS-ja i kërkon Gjykatës së Procedurës
11 Paraprake që të përcaktojë afatet për ZPS-në për sa i takon
12 kundërshtimeve materiale dhe të japë parashtrimet e nevojshme.

13 Ndërkohë që Mbrojtja e z. Kilaj thotë që z. Kilaj ka të
14 drejtë që të zgjedhë çështje të caktuara të cilat janë të
15 vështira për t'u zgjidhur në këtë fazë të procesit gjyqësor
16 dhe që nuk janë trajtuar siç duhet nga Vendimi Kuadër
17 përkatës.

18 Përpara se t'i jap fjalën ZPS-së, dëshiroj që t'i kujtoj
19 ZPS-së që nxjerrja ose inspektimi i provave që, për shembull,
20 deklarata, dokumente, fotografi ose objekte të tjera të
21 prekshme, që kanë rëndësi materiale për Mbrojtjen, i duhen
22 nxjerrë Mbrojtjes sipas parashikimeve në rregullën 102(3),
23 fjalia e tretë.

24 Njoftimi i hollësishëm për material të tillë duhet të
25 përfshijë informacionin që ZPS-ja e vlerëson si me rëndësi

1 potencialisht materiale për Mbrojtjen, për përgatitjen e saj,
2 po materialet dhe provat në posedimin e ZPS-së të cilat nuk
3 janë nxjerrë sipas rregullit 102(1)(a)(b) dhe 103 dhe që janë
4 relevante për çështjen aktuale.

5 Po ashtu i kujtoj palëve që mosmarrëveshjet lidhur me
6 rëndësinë materiale të informacionit, siç pretendohet nga
7 Mbrojtja, duhet të dorëzohet menjëherë përpara Gjykatës së
8 Procedurës Paraprake për zgjidhje sikurse përcaktohet në
9 rregullin 102(1)(a)(b).

10 I kërkoj ZPS-së tani që të japë përgjigje lidhur me këto
11 pyetje:

12 Së pari, a mundet ZPS-ja sot të japë një vlerësim të
13 përafërt të llojit dhe volumit materialit që bie në fushën e
14 rregullës 102(3) që do të përmbahet në njoftimin e hollësishëm
15 të parë që ka datën 17 shkurt 2025 për Mbrojtjen?

16 Pyetja e dytë është kjo: A mundet ZPS-ja sot të japë
17 informacion se sa redakte do të nevojiten, në qoftë se do të
18 nevojiten, në këtë njoftim të parë?

19 Dhe, së treti, do i kërkoja ZPS-së që të japë hollësi të
20 tjera që dëshiron të bëjë me dije për palët.

21 Zoti ose znj. Prokurore, keni fjalën ju.

22 Z. HAFETZ: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.
23 Lidhur e me pyetjen e dytë, më lejoni të them që për
24 materialin për të cilin po flasim, ne nuk mund të japim një
25 vlerësim të plotë, pra, sa i takon regjimit të redakteve në

1 këtë çështje do jetë i kufizuar dhe shpresojmë që nuk do ketë
2 shumë redakte. Domethënë, ne nuk parashikojmë që të kemi
3 redakte të shumta në materialin.

4 Ndërkohë që sa i takon volumit përkatës të dokumenteve
5 nuk mund t'ju jap një informacion të saktë lidhur me këtë.
6 Lloji i provave që kemi ne në zotërim tonë pasqyrojnë, pra,
7 atë material që përcaktohet në rregullën 102(3).

8 Pra, me fjalë të tjera mund të ketë informacione sipas
9 rregullës 102(3) nga telefonat e sekuestruar të individëve.
10 Mund të ketë edhe disa materiale të mbetura të tjera të
11 rregullës 102(3) që mund të jenë në trajtën e transkripteve
12 ose përkthimeve të regjistrimit në audio të telefonatave në
13 paraburgim, gjithashtu edhe dokumente të tjera të
14 paraburgimit, të objektit të paraburgimit. Domethënë, pak a
15 shumë këto janë llojet e informacionit që ne kemi identifikuar
16 dhe që do të duhet të nxirren sipas rregullës 102(1)(b).

17 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit,
18 z. Prokuror.

19 Tani do i kërkoj Mbrojtjes që të bëjë parashtrimet e veta
20 duke filluar këtu me znj. Menegon.

21 ZNJ. MENEGON: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Nuk kemi
22 ndonjë konstatim të posaçëm, vetëm thjesht duam që të ftojmë
23 Prokurorinë që të na informojë në mënyrë sistematike lidhur me
24 materialet që kanë të bëjnë me njoftimin sipas rregullës
25 102(3) dhe gjithashtu të lidhë këtë informacion me emrin e të

1 akuzuarit.

2 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, Avokate. E
3 mbajtëm shënim për procesverbal.

4 Avokati Martens.

5 Z. MARTENS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.
6 Mesa e dëgjova kolegun, ai thotë që dokumenti sipas rregullës
7 102(3) është një reflektim ose pasqyrim i dokumenteve ose
8 materialeve sipas rregullës 102(1)(a) dhe (b), do i kërkoj
9 Prokurorisë të thotë ose të na shpjegojë se pse nuk është e
10 mundur, përderisa edhe regjimi i redaktimeve nuk është kaq
11 shumë i zgjeruar, pse nuk është e mundur që këto prova do
12 jepen së bashku me provat që janë planifikuar për neve këtë
13 javë.

14 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

15 Avokati Pestman.

16 Z. PESTMAN: [Përkthim] Faleminderit. Unë nuk kam komente
17 për këtë pikë.

18 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

19 Avokati Admiraal.

20 Z. ADMIRAAL: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Nuk kam
21 asgjë për të shtuar.

22 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull. E mbajtëm
23 shënim.

24 Tani Avokati Edwards.

25 Z. EDWARDS: [Përkthim] Jo, nuk kam asgjë për të shtuar.

1 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Tani do t'i jap përsëri
2 fjalën Prokurorit në mënyrë të tillë që t'i përgjigjet pyetjes
3 së bërë prej Avokatit Martens.

4 Z. HAFETZ: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë që nuk isha i
5 qartë mjaftueshëm për kolegun. Unë jam përpjekur që ta
6 shpjegoj këtë element në paragrafin 30 të parashtimeve tona.
7 Unë po mundohesha që t'i jepja përgjigje pyetjes së bërë prej
8 jush, e nderuar znj. Gjykatëse. Pra, unë për momentin nuk mund
9 të parashikoj të gjitha llojet e provave sepse varet se çfarë
10 kundërshtimesh ose argumentesh do kenë Ekipet e Mbrojtjes. Dhe
11 ajo çfarë është më e rëndësishme do të duhet që të përcaktojmë
12 provat tona dhe cilado jetë trajta ose forma përfundimtare e
13 këtyre provave sipas rregullës 102(1)(b).

14 Pra, nuk dhashë një listë të hollësishme të llojit të
15 materialeve. Por thjesht unë dhashë disa shembuj, si për
16 shembull, deklaratat e dëshmitarëve të cilët mund të bien nën
17 rregullën 102(3). Nuk mund t'i përgjigjem pyetjes së bërë prej
18 avokatit tani. Sepse bëhet fjalë për kategoritë në përgjithësi
19 të dokumenteve të cilat do të nxirren për këtë arsye isha i
20 përgjithshëm në atë çfarë thashë.

21 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, Prokuror. I
22 mbajta shënim parashtimet tuaja dhe sikurse e thashë dhe më
23 përpara do të nxjerr një vendim që do të përcaktojë afatet dhe
24 do të jepen udhëzime gjithashtu lidhur me procesin e nxjerrjes
25 së materialeve sipas rregullës 102(3) në vendimin e radhës.

1 Tani do të kalojmë tek pika pestë e rendit të ditës, që
2 ka të bëjë me materialin sipas rregullës 102(3) që ka të bëjë
3 me provat shfajësuese.

4 Kështu që i kam kërkuar ZPS-së që të japë informacion
5 specifik lidhur me sasinë dhe volumin e provave shfajësuese në
6 kuptimin e rregullës 102(3) që është nën ruajtjen, kontrollin
7 ose njohurinë aktuale të ZPS-së deri më sot edhe zbërthimit të
8 tyre që ka të bëjë me pikën 5(a) të rendit të ditës.

9 Dhe, së dyti, në qoftë se redaktimet janë në nevojshme
10 apo jo për këtë nxjerrje materiale, kjo ka të bëjë me pikën
11 5(b) të rendit të ditës.

12 Tani përsëri do bëj një përmbledhje të shkurtër të
13 parashtrimeve të ZPS-së lidhur me këtë pikë.

14 ZPS-ja do të nxjerrë për pak një paketë të materialit
15 potencial sipas rregullës 103 dhe materiale të tjera
16 shfajësuese menjëherë pasi të bëhen redaktimet e nevojshme.

17 Përpara sesa t'i jap fjalën ZPS-së, i kujtoj ZPS-së që
18 duhet t'i nxjerrë menjëherë Mbrojtjes çdo provë shfajësuese
19 sapo ato ta kenë nën ruajtjen, kontrollin ose njohurinë
20 aktuale të tyre që mund të sugjerojnë mënyrë të arsyeshme ose
21 që mund të lidhet me pafajësinë e të akuzuarit ose me fajësinë
22 e tij ose mund të ketë ndikim mbi besueshmërinë ose
23 mbështetëshmërinë e provave të Prokurorit të Specializuar.

24 Nxjerrja e provave shfajësuese është një detyrim i
25 vazhdueshëm vetëm sa i takon masa mbrojtëse në qoftë se janë

1 të domosdoshme.

2 Informoj gjithashtu palët që të respektojnë detyrimin e
3 vazhdueshëm të ZPS-së sa i takon zbatimit efektiv të nxjerrjes
4 së materialeve sipas rregullit 103.

5 Dua të ftoj së pari ZPS-në që të na thotë se çfarë lloji
6 dhe çfarë volumi materiale shfajësues kanë në dispozicion
7 sipas rregullës 103? A është në gjendje ZPS-ja që të marrë më
8 shumë informacion?

9 Dhe a është i saktë prezumimi im që paketa e parë e
10 materialit shfajësues nuk ka nevojë për redaktime?

11 Po ashtu, së treti, do t'i kërkoj ZPS-së që të na japë
12 hollësi të tjera të lidhura me këtë pikë.

13 Fjala tani është për ZPS-në për të plotësuar parashtimet
14 e bëra më herët ose për të dhënë sqarime në qoftë se është e
15 nevojshme

16 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
17 Gjykatëse. Atëherë paketa e parë sipas rregullës 103 do të
18 përfshijë tre kategori, pra, ose tre dokumente. Këto tre
19 dokumente janë si më poshtë: janë dy deklarata dëshmitarësh,
20 një shënim zyrtar i një bisede me një dëshmitar dhe asnjë prej
21 këtyre dokumenteve nuk ka nevojë për redaktime. Faleminderit.

22 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit ju.

23 Tani do t'i jap fjalën Mbrojtjes për të bërë parashtimet
24 e tyre koncize lidhur me redaktimet që duhet të aplikohen në
25 pajtim me atë çfarë është përcaktuar në Konferencën për

1 Ecurinë e Çështjes.

2 Së pari e ka fjalën Avokatja Menegon.

3 ZNJ. MENEGON: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]

4 Faleminderit.

5 Sa i takon regjimit të redaktimeve, e kam bërë me dije
6 dhe në parashtrimet tona me shkrim që ne nuk jemi kundërshtim
7 për zbatimin e qasjes që është përcaktuar në vendimin F76.

8 Faleminderit.

9 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit. E mbajtëm
10 shënim.

11 Avokati Martens.

12 Z. MARTENS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

13 Duke marrë parasysh atë çfarë tha ZPS-ja lidhur me provat
14 sipas 103, ne do ju kërkonim ju, e nderuar Gjykatëse, që ju të
15 urdhëroni ZPS-në që këto materiale të na nxirren deri në fund
16 të javës.

17 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull. E mbajta
18 shënime këtë.

19 Tani fjala është për Avokatin Pestman.

20 Z. PESTMAN: [Përkthim] Për ta kuptuar drejt pyetjen që
21 bëtë ju, ju po më pyesni mua në qoftë se unë pajtohem ose z.
22 Fazliu pajtohet me kuadrin e propozuar të redaktimeve ashtu
23 siç është formuluar në vendimin për Januzin? Në qoftë se
24 pyetja është kjo? Përgjigja ime është që ne nuk kemi
25 kundërshtim për këtë kuadër, për këtë kornizë të përcaktuar.

1 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

2 Avokati Admiraal.

3 Z. ADMIRAAL: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim.

4 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Avokati Edwards.

5 Z. EDWARDS: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim me kusht që
6 merren parasysh parashtrimet që kemi dhënë nën paragrafin 24
7 të parashtrimit tonë të protokolluar.

8 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull. E mbajtëm
9 shënim këtë.

10 Edhe parashtrimet tuaja merren parasysh. Dhe sikurse e
11 kemi thënë më përpara ne do të nxjerrim një Vendim Kornizë
12 duke dhënë udhëzime sa i takon procesit të nxjerrjes së
13 materialeve sipas rregullës 103 dhe këtë do ta gjeni në
14 Vendimin e radhës Kornizë.

15 Tani do të kalojmë tek materiali i mbrojtur sipas
16 rregullës 107.

17 I kam kërkuar ZPS-së, i kam bërë disa pyetje që kanë të
18 bëjnë me material që ato do të ofrojnë në prova që do të
19 kërkojnë që të regjistrohen në prova dhe që janë materiale
20 konfidenciale. Kjo është pika 6(a) deri në (f) të rendit të
21 ditës.

22 Vërej që në fazën aktuale materiali që ZPS-ja synon që të
23 ofrojë për regjistrim në prova materiale nuk kërkon autorizim
24 dhe nuk kërkon, pra, nuk kërkon që t'i nënshtrohet
25 përcaktimeve në rregullin 107.

1 Znj. Prokurore, keni ndonjë gjë për të shtuar lidhur me
2 këtë?

3 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Jo, nuk kemi parashtime të
4 tilla lidhur me këtë temë.

5 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull.

6 Tani po shikoj ekipet e Mbrojtjes, në qoftë se ndonjëri
7 prej kipeve të Mbrojtjes dëshiron të thotë diçka lidhur me
8 materialet që parashikohen në rregullën 107? Shoh që nuk ka
9 parashtime nga palët.

10 Dhe sikurse e thashë edhe më herët, unë do jap udhëzime
11 në Vendimin Kornizë lidhur me kërkesat për kërkesën për
12 mbajtjen e informacionit sipas rregullit 107 në vendimin e
13 ardhshëm që do të marrë në rast që kërkesa të tilla do të
14 ngrihen apo do të depozitohen përpara meje.

15 Tani do të kalojmë tek regjimi i propozuar i redaktimeve
16 që është pika 7 e rendit të ditës.

17 Kujtoj që iu kam kërkuar palëve në qoftë se ata pajtohen
18 që të zbatohet regjimi i redaktimeve që është miratuar në
19 Çështjen 10 në Vendimin Kornizë për nxjerrjen e materialeve
20 dhe çështje lidhur me to.

21 Vërej se në parashtimet përkatëse, ZPS-ja dhe Mbrojtja e
22 z. Thaçi janë pajtuar që të miratojnë regjimin e redaktimit të
23 mëparshëm.

24 Po ashtu vërej që Mbrojtja e z. Kilaj pajtohet me këtë në
25 parim, megjithatë thotë që rezervon të drejtën që të kërkojmë

1 mjete efektive alternative për të zgjidhur çështje që janë të
2 vështira për t'u parashikuar në këtë fazë të procesit
3 gjyqësor.

4 Z. Prokuror, shikoj poshtëshënimin 3 në parashtrimet
5 tuaja që ju propozoni redakte në bllok që të zbatohen për
6 materiale të cilat në janë relevante për procedurat aktuale
7 kur, për shembull, një transkript që përfshinë dëshminë e dy
8 dëshmitarëve, njëra, vetëm njëra prej tyre ka rëndësi ose
9 është relevante për këtë proces gjyqësor. A e kuptoj drejt unë
10 që ju po propozoni një kategori të re të redaktimeve
11 standarde, e kam kuptuar drejt këtë, apo jo?

12 E keni fjalën ju, Prokuror.

13 Z. HAFETZ: [Përkthim] Për këto lloj redaktimesh, po, e
14 keni kuptuar drejt.

15 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull. Kjo është
16 tashmë në procesverbal.

17 I drejtohem ekipeve të Mbrojtjes dhe dua të më japin
18 parashtrimet e tyre koncize lidhur me sistemin e redaktimeve,
19 veçanërisht për këto që diskutuam në Konferencën mbi Ecurinë e
20 Çështjes gjyqësore. Gjithashtu mund të na jepni mendimet tua
21 lidhur me krijimin e një kategorie të re standarde ose ndryshe
22 redaktimet bllok që propozon Prokuroria për materialet që nuk
23 kanë lidhje me këtë lëndë gjyqësore.

24 Avokatja Menegon, keni dëshirë të shtoni diçka përveç
25 atyre që keni thënë me shkrim në emër të z. Thaçi?

1 ZNJ. MENEGON: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Do t'ju
2 përgjigjem pyetjes për kategorinë e re. Ne nuk e mbështesim
3 krijimin e një kategorie të re sepse edhe nëse ZPS-ja, në
4 qoftë se ZPS-ja mendon që këto materiale nuk janë relevante
5 apo nuk lidhen me dëshmitarin në këtë procesin gjyqësor,
6 informacioni mbase mund të ketë lidhje për kontekst dhe mund
7 të jetë i rëndësishëm, për shembull, mund të ketë lidhje dhe
8 në mënyrë të tërthortë, pra, me këtë lëndë.

9 Kështu që me përjashtim të rasteve kur duhet bërë
10 redaktimi për të mbrojtur identitetin e një individi, ne nuk e
11 mbështesim krijimin e një kategorie të re për redakte bllok.

12 GYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

13 Avokati Martens.

14 Z. MARTENS: [Përkthim] Mbështes avokaten e z. Thaçi dhe
15 ne përgjithësisht nuk jemi pro redakteve. Dua ta bëj të
16 qartë këtë. Së dyti, vetëm në qoftë se është e nevojshme për
17 mbrojtjen e identitetit të ndonjë personi të caktuar por sa më
18 të kufizuara që të jetë e mundshme sepse pala që do të vendosë
19 lidhur me redaktimin nuk jemi ne, çka do të thotë Mbrojtja nuk
20 ka asnjë të drejtë të flasë në lidhje me këtë, prandaj ne nuk
21 e mbështesim krijimin e një sistemi të ri redaktimesh.

22 GYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

23 Avokati Pestman.

24 Z. PESTMAN: [Përkthim] Unë ua shpjegova më herët që ne e
25 mbështesim sistemin e redakteve që keni propozuar ju në

1 lëndën Jonuzi. Por nuk pajtohem që të shtohet kategori e re.
2 Nëse e kuptova unë qartë Prokurorinë, ata dëshirojnë të
3 fshijnë disa pjesë të materialeve që gjykojnë që nuk janë
4 relevante për lëndën tonë gjyqësore, megjithatë unë mendoj që
5 relevanca nuk duhet të jetë kusht për fshirjen e materialeve,
6 përkundrazi, materialet do t'i jepen në tërësinë e vet Ekipeve
7 të Mbrojtjes. Pra, edhe ne e kundërshtojmë.

8 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Avokati Admiraal.

9 Z. ADMIRAAL: [Përkthim] Edhe ne të njëjtin qëndrim kemi.
10 I bashkohem fjalës së z. Pestman.

11 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] E morëm parasysh.

12 Avokati Edwards, do të doja që ju të na jepnit më
13 konkretisht shqetësimet që keni lidhur me sistemin e
14 redaktimeve që është ndjekur në Lëndën 10. A keni ndonjë gjë
15 specifike lidhur me sistemin, në mënyrë që ta kuptoj unë qartë
16 përpara se të nxjerrë Vendimin Kornizë ditën e premtë.

17 Fjala është për ju.

18 Z. EDWARDS: [Përkthim] Unë fillimisht dua t'ju them që sa
19 i takon zgjerimit të sistemit të redaktimeve, unë mbështes
20 parashtrimet që bënë kolegët e mi.

21 Në paragrafin 24 të parashtrimeve tona, unë e përmenda
22 dhe më herët në fakt paragrafin 24 dhe thashë se do të flas
23 për sistemin e materialeve. Po sa i takon sistemit të
24 redaktimeve, ajo që kemi dashur të sqarojmë ne, kemi dashtë të
25 themi që mund të ketë raste të vështira kur redakte para

1 ekzistuese apo sisteme ekzistuese mbase nuk do funksionojnë
2 për ne. Në paragrafin 24 ne kemi shprehur qëndrimin tonë dhe
3 ku kemi thënë që në një rast të vështirë, ne duam të kemi të
4 drejtën të bëjmë parashtime specifike për redaktimet që do
5 t'i bëhen një materiali konkret, lidhur me një dëshmitar
6 konkret, nëse doni të jeni të drejtë me Mbrojtjen, ne duam
7 patjetër që të bëjmë parashtime atëherë nëse gjykojmë se ne
8 po na cenohet e drejta. Faleminderit.

9 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] ZPS-ja dëshiron të shtojë
10 gjë lidhur me kundërshtimet e përgjithshme për krijimin e një
11 kategorie të re?

12 Z. HAFETZ: [Përkthim] Shkurtimisht, që ta sqarojmë, mbase
13 ta sqaroj çfarë po përpiqem të them.

14 Nëse kemi transkripte një lëndë tjetër gjyqësore dhe në
15 një ditë aty është përmendur dëshmia e dy dëshmitarëve të
16 ndryshëm, pra, një prej dëshmitarëve nuk ka lidhje fare me
17 këtë lëndën tonë gjyqësore dhe njëri është tërthorazi i lidhur
18 me këtë lëndë gjyqësore dhe mendojmë që një është relevant dhe
19 një nuk është irelevant. Prandaj ne duam të krijojmë një
20 kategori të re që materialet që të japim të jenë vërtetë
21 materiale relevante edhe materialet që nuk kanë pse t'i jepen
22 ekipeve të Mbrojtjes të redaktohen në tërësinë e vet, në bllok
23 pra.

24 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull. E morëm
25 parasysh.

Unë do të nxjerr Vendim Kornizë ku do të parashihet edhe sistemi i redaktimeve për këtë lëndë gjyqësore.

Kalojmë tani në pikën e fundit në rendin e ditës që është pika 8, që është procedura për nxjerrjen e materialeve, më konkretisht kategorizimi në sistemin *Legal Workflow* për materialet që janë objekt i rregullës 102(1)(a) dhe (b) dhe rregullës 104(1), (5) dhe (6) në kohën e nxjerrjes së paketës së materialeve në fjalë.

Mora parashtimet e Mbrojtjes në lidhje me këtë, ku thanë se do t'i propozojnë Mbrojtjes së çdo të akuzuari bazuar në një format të ngjashëm që është ndjekur në çështjen Januzi dhe të tjerët në mënyrë që të garantohen që çdo propozim të pasqyrojë apo të jetë në përputhje me rrethanat e kësaj lënde konkrete dhe të përmbushë nevojat e palëve, por gjithashtu duke marrë parasysh edhe kufizimet e burimeve që ka gjithsecili.

Nuk propozon krijimin e nënkategorive në këtë tabelë dhe propozon që të krijohet një tabelë përmbledhëse sipas rregullës 109, 15 ditë nga dorëzimi nga çdo dosje paraprake.

Sa i takon formatit të tabelës 109, ZPS-ja propozon miratimin e të njëjtit shabllon, pra, format që është përdorur në lëndën Januzi dhe të tjerët, Gucati dhe Hajradinaj, si dhe në lëndën Pjetër Shala. Gjegjësisht, ZPS-ja propozon ta kufizojë tabelën për materialet e rregullës 102(1)(b) sepse materialet e rregullës 102(1)(a) janë përfshirë tashmë në

1 tabelën e rregullës 86(3) (b). Ju lutem shihni paragrafin 42 të
2 parashtrimeve të ZPS-së lidhur me këtë.

3 Së fundi, ZPS-ja informon Gjykatësen e Procedurës
4 Paraprake se po vijnë diskutimet mes palëve.

5 Gjithashtu marr parasysh që Mbrojtja e z. Thaçi pajtohet
6 parimisht që të ketë komunikime *inter partes* me synim që të
7 bien dakord për kategorizimet që përshtaten me këtë lëndë
8 gjyqësore me sistemin *Legal Workflow* njësoj siç është vepruar
9 në lëndën Januzi dhe të tjerët dhe me formatin e tabelës
10 përmbledhëse që është përdorur në lëndën Januzi dhe të tjerët.

11 Së fundi, Mbrojtja e Thaçit pajtohet me propozimin e ZPS-
12 së që tabela për nxjerrjen e materialeve të dorëzohet brenda
13 15 ditësh nga data e dorëzimit të dosjes paragjyqësore.

14 Ftoj ZPS-në të japë plotësime nëse është e nevojshme dhe
15 të lutem të na thonë ku jeni me diskutimet mes palëve sa i
16 takon tabelës sipas rregullës 109 dhe kur duhet ta pres një
17 përgjigje prej jush.

18 Zoti apo znj. Prokurore, fjala është për ju.

19 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit. Sa i takon
20 kategorizimit, ne pajtohemi me kategoritë që janë propozuar
21 dhe janë evidentuar prej jush në rendin e ditës për këtë
22 konferencë mbi ecurinë e çështjes gjyqësore dhe aktualisht nuk
23 mendojmë se duhet të shtojmë nënkategori të tjera.

24 Unë do t'ju jap një përditësim të shkurtër lidhur me
25 komunikimin që kemi ne me palët. Javën e kaluar ZPS-ja ndau

1 një shabllon sipas rregullës 109 me të gjithë të akuzuarit,
2 me avokatët përkatës - më falni - nuk morëm asnjë kundërshtim
3 lidhur me këtë shabllon. Megjithatë avokati i z. Fazliu nuk ka
4 komentuar në lidhje me këtë. Sidoqoftë ne do të komunikojmë me
5 avokatin në mënyrë që të gjejmë një zgjidhje së bashku brenda
6 kësaj jave. Megjithatë e kuptoj që avokati ka pasur probleme
7 të hyjë në sistemin *Legal Workflow* në mënyrë që të shohë
8 materialet përkatëse. Faleminderit.

9 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

10 I drejtohem tashmë ekipeve të Mbrojtjes nëse ka ndonjë
11 parashtim.

12 Ju lutem keni parasysh katër pyetjet konkrete.

13 Një, a pajtoheni ju me tabelën e rregullës 109 që është
14 përdorur dhe në lëndën Januzi dhe të tjerët që i përmenda më
15 herët?

16 A pajtoheni me propozimin e ZPS-së se tabela duhet të
17 përmbajë vetëm materiale të rregullës 102(1)(b), sepse
18 materialet e rregullës 102(1)(a) janë analizuar mjaftueshëm në
19 tabelën e rregullës 86(3)(b)?

20 Dhe a pajtoheni që tabela përmbledhëse sipas rregullës
21 109 të dorëzohet brenda 15 ditësh nga data e dorëzimit të
22 dosjes paragjyqësore?

23 Avokatja Menegon, fjala është për ju, për të shtuar
24 lidhur me parashtimet që keni bërë me shkrim në emër të z.
25 Thaçi.

1 ZNJ. MENEGON: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Na ka
2 dërguar me postë elektronike ZPS-ja një shabllon. Ne i kemi
3 konfirmuar pajtimin që kemi ne me këtë model, me këtë
4 shabllon, sidoqoftë do donim që përveç kategorive që "lidhen
5 me sjelljen e të akuzuarve", të përmenden edhe emrat e secilit
6 të akuzuar përbri secilit çdo dokument, pra, që ta kuptojmë ne
7 për cilin të akuzuar është secili dokument.

8 Më lejoni të shoh dhe pyetjet e tjera.

9 Sa i takon përmbajtjes së tabelës, mendojmë se do të
10 ishte e dobishme që tabela të përmendë edhe materialet e
11 rregullës 101(a) dhe 102(1)(b), sidomos sepse lista e
12 rregullës 102(1)(a) është e shkurtër dhe nuk do të ishte
13 ndonjë problem për ZPS-në, por për ne do të ishte shumë mirë
14 që t'i kishim të gjitha materialet në një dokument të vetëm.

15 Dhe siç thamë dhe në parashtimet me shkrim ne mendojmë
16 se do të kemi një vonesë me 15 ditë për të dorëzuar këtë
17 tabelë pas dorëzimit të dosjes sonë paragjyqësore.
18 Faleminderit.

19 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

20 Avokati Martens.

21 Z. MARTENS: [Përkthim] Vetëm një koment kam në fakt. Do
22 të ishte shumë e lehtë që në tabelë të shtonim materialet e
23 rregullës 102(1)(a) në mënyrë që ne të kemi një panoramë të
24 plotë të të gjitha provave dhe materialeve që ekzistojnë në
25 këtë tabelë.

1 Sa i takon pyetjes suaj, ne do të shohim, ne pranojmë
2 vendimin tuaj. Mendojmë që propozimi juaj në fakt është shumë
3 praktik.

4 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

5 Avokati Pestman.

6 Z. PESTMAN: [Përkthim] Faleminderit. Prokurori në fakt ka
7 të drejtë. Unë ende s'e kam parë këtë tabelë, prandaj dhe nuk
8 kam pasur mundësi të përgjigjem. Nuk e di për çfarë bëhet
9 fjalë, nuk e di as çfarë pamje ka kjo tabelë. Prandaj e kam
10 shumë të vështirë që të shprehem aktualisht për tabelën për të
11 cilën po diskutoni.

12 Por dhe unë pajtohem që është mirë që të jenë të gjitha
13 materialet në një tabelë të vetme, kështu që ju lutem
14 përfshini të gjitha materialet mbështetëse në një dokument të
15 vetëm, në këtë tabelën konkrete që duhet të marrim
16 përfundimisht. Unë, sigurisht, që do të angazhohem veçanërisht
17 me Prokurorinë lidhur me këtë temë konkrete. Faleminderit.

18 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, Avokati
19 Pestman.

20 Avokati Admiraal, fjala është për ju.

21 Z. ADMIRAAL: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Nuk kam
22 kundërshtime dhe nuk kam asgjë për të shtuar.

23 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, Avokat.

24 Avokati Edwards.

25 Z. EDWARDS: [Përkthim] Po. Pajtohemi dhe ne. Tabela duhet

1 të jetë sa më e plotë që të jetë e mundshme. Kjo është
2 preferenca jonë. Dhe ju thatë që mbase nuk është e nevojshme
3 që materialet e rregullës 102(1)(a) në këtë tabelë sepse janë
4 analizuar mjaftueshëm në përmbledhjen e rregullës 86(3)(b). Po
5 nuk të komentojmë se s'e kemi parë këtë përmbledhjen e kësaj
6 rregullës 86(3)(b) dhe nuk mund të bëjmë asnjë parashtrim në
7 lidhje me këtë.

8 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

9 Ka diçka për të thënë Prokuroria?

10 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Jo. U qëndroj parashtrimeve që
11 bëme tashmë lidhur me këtë pikë.

12 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

13 Faleminderit për të gjitha parashtrimet tuaja. Mesa shoh ende
14 nuk kemi një marrëveshje mes të gjitha palëve për kategoritë
15 dhe tabelat përkatëse, unë do ju jap afatet që të bëni
16 parashtrimet lidhur me këtë aspekt në Vendim tim Kornizë.

17 Dhe këtu mbylлим dhe pikën 8 në rendin tonë të ditës.

18 Përpara se t'u jap fjalën palëve që të trajtojnë aspekte
19 të tjera që mund të gjykojnë të nevojshme, më lejoni të
20 trajtoj pak afatet për dokumentin F87 dhe F88, që janë
21 kërkesat e ZPS-së që janë dorëzuar sot paradite dhe të
22 informoj ekipet e Mbrojtjes lidhur me procesin e
23 riklasifikimit që është në vazhdimësi e sipër në këtë lëndë
24 gjyqësore, siç edhe e përmenda në fillim të seancës.

25 Sa i takon afateve për parashtrimet F87 vërej se ZPS-ja

1 do të dorëzojë një version të redaktuar konfidencial brenda të
2 enjtes, 19 dhjetor 2024 më së fundi. Kërkoj veçanërisht
3 pikëpamjet e Mbrojtjes sa i takon protokollit për trajtimin e
4 informacionit konfidencial dhe kontaktimit të dëshmitarëve dhe
5 viktimave. Duke marrë parasysh që po afrohen pushimet e
6 Gjykatës, Mbrojtja kur gjykon se mund të bëjë parashtime në
7 lidhje me këtë?

8 I jap fjalën fillimisht Avokates Menegon.

9 ZNJ. MENEGON: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Në fakt ne
10 diskutuam me Prokurorinë dhe me ekipin e Kilajt për pezullimin
11 e afateve gjatë pushimeve të Gjykatës dhe besoj se të gjitha
12 palët ranë dakord. Kështu që nëse e merrni parasysh kërkesën
13 tonë, afatet të jenë pas përfundimit të pushimeve të Gjykatës.

14 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] E morëm parasysh.
15 Faleminderit.

16 Avokati Martens?

17 Z. MARTENS: [Përkthim] Pas pushimeve të Gjykatës
18 propozojmë edhe ne. Faleminderit.

19 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Avokati Pestman.

20 Z. PESTMAN: [Përkthim] Pajtohem edhe unë me kolegët.
21 Faleminderit.

22 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Avokati Edwards.

23 Z. EDWARDS: [Përkthim] Mbase nuk do habiteshit po t'ju
24 thoja që dhe ne pajtohemi me kolegët.

25 GJYKATËSJA MASSELOT: [Mikrofoni çaktivizuar].

1 [Përkthim] Më falni. Ju kërkoj ndjesë, se unë harrova
2 Avokatin Admiraal.

3 Z. ADMIRAAL: [Përkthim] Nuk ka problem. Edhe ne
4 propozojmë pas pushimeve të Gjykatës.

5 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë.

6 Z. Prokuror, fjala është për ju.

7 Z. HAFETZ: [Përkthim] S'kemi kundërshtime.

8 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Tani do të jap urdhrin e
9 pestë me gojë lidhur me afatet për kërkesat e ZPS-së me numër
10 F87.

11 Udhëzoj Zyrën Administrative të bëjë parashtrime lidhur
12 me kërkesat e ZPS-së nëse ka, brenda të martës 14 janar 2025
13 në orën 4.00 të pasdites dhe Mbrojtja, nëse dëshiron, t'u
14 përgjigjet versioneve të redaktuara konfidenciale të
15 materialit F87 dhe parashtrimeve të Zyrës Administrative,
16 sipas rastit, brenda të enjtes 16 janar 2025. ZPS-ja mund të
17 kundërpërgjigjet brenda të martës 21 janar 2025.

18 Këtu mbyll urdhrin e pestë me gojë.

19 Siç e përmenda sot kur filluam, Gjykatësja e Procedurës
20 Paraprake dhe palët janë njoftuar për kërkesën e ZPS-së me
21 numër F88 me klasifikim konfidencial që ka të bëjë me
22 Mbrojtjen e z. Fazliu. Nuk po hyj në detale të kësaj kërkesë
23 sepse është konfidenciale kërkesa.

24 Por vendimi në fjalë mban numrin F38 dhe aktualisht është
25 i klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

1 Informoj Mbrojtjen e z. Fazliu se ky vendim do t'i jepet
2 Mbrojtjes në afatin e parashikuar. Ftoj Mbrojtjen e z. Fazliu
3 të më informojë kur do t'i përgjigjen kërkesës duke marrë
4 parasysh afrimin e pushimeve të Gjykatës.

5 Rrjedhimisht, Avokati Pestman, fjala është për ju.

6 Z. PESTMAN: [Përkthim] E kam shumë të vështirë t'u
7 përgjigjem tani sepse nuk e kam idenë për çfarë po flasim.

8 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Është një dokument
9 konfidencial. E di që keni pas probleme me sistemin.

10 Z. PESTMAN: [Përkthim] Ju po thoni rreptësishtë
11 konfidencial dhe *ex parte*. A e kuptova unë drejt?

12 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Bëhet fjalë për
13 materialin F88, është një kërkesë e ZPS-së konfidenciale dhe
14 është dorëzuar sot paradite dhe ka lidhje me klientin tuaj.

15 Z. PESTMAN: [Përkthim] Atëherë unë nuk e kam parë
16 materialin dhe s'mund të përgjigjem. Nëse ma jepni vendimin do
17 ta shoh dhe do përgjigjem më vonë.

18 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Sidoqoftë, është ora
19 4.00, mbase është momenti që të bëjmë një pushim, që të marrim
20 pak veten të gjithë.

21 Kështu që unë propozoj kështu, Avokati Pestman, do bëjmë
22 një gjysmë ore pushim tani, në mënyrë që ju të njiheni me këtë
23 dokument, ta shihni dokumentin dhe kur të kthehemi nga pushimi
24 mund të bëni parashtrimin tuaj.

25 Në rregull. Bëjmë një pushim për gjysmë ore, rikthehemi

1 në sallën e gjyqit në orën 4.30.

2 --- Pauza fillon në orën 16.01

3 --- Seanca rifillon në orën 4.33

4 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Jemi në seancë. Dhe për
5 procesverbal theksoj se të gjitha palët dhe përfaqësuesit e
6 Zyrës Administrative janë të pranishëm në sallë.

7 Tani i drejtohem Avokatit Pestman. A patët mundësi që
8 gjatë pauzës ta lexoni parashtrimin F88 të Prokurorisë? Në
9 qoftë se po, a mund të më thoni se kur do të jeni të gatshëm
10 t'i përgjigjeni duke mbajtur parasysh pushimin e Gjykatës që
11 afrohet.

12 Z. PESTMAN: [Përkthim] Po, faleminderit. E kam parasysh
13 që dokumenti është i shënuar si konfidencial. Nuk kam problem
14 që të përgjigjem tani, por mund të kalojmë në seancë të
15 mbyllur.

16 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Vetëm duhet, vetëm të më
17 thoni se kur e keni ndërmend të përgjigjeni.

18 Z. PESTMAN: [Përkthim] Nuk do të jem në gjendje të
19 përgjigjem tani. Duhet të flas një herë me klientin tim në
20 takim konfidencial dhe ndërkohë në mënyrë që të mund t'i
21 përgjigjem atij dokumenti. Mbaj parasysh që vendimi F38
22 përmendet në paragrafët 1, 3, 4, 5 dhe 7 të kërkesës së
23 Prokurorisë dhe pothuajse në çdo rast i bëhet referenca
24 arsyeve të paracaktuara në atë vendim. Kështu që për mu është
25 e vështirë që të përgjigjem pa e pasur edhe atë dokument.

1 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Përsëri po ju them, i
2 nderuar avokat, se nuk po ju kërkoj që të bëni parashtime
3 konkrete për këtë kërkesë të ZPS-së. Thjesht duhet të më thoni
4 se kur do të jeni i gatshëm që të përgjigjeni duke mbajtur
5 parasysh pushimin dimëror të Gjykatës.

6 Z. PESTMAN: [Përkthim] Do të jem në gjendje të përgjigjem
7 ose avokati që do të më zëvendësoj, besoj, që do të jetë në
8 gjendje të përgjigjet pasi të ketë marrë vendimin F38 dhe pas
9 marrjes së atij dokumenti, besoj, që brenda një jave do të jem
10 i gatshëm të përgjigjem.

11 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit. Ju thatë se
12 këtë nuk patët mundësi ta diskutoni me klientin tuaj?

13 Z. PESTMAN: [Përkthim] Po, kisha mundësi të flas këtu në
14 sallë por nuk ishte takim konfidencial. Meqë nuk ishim vetëm.

15 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Fikeni mikrofonin.

16 A ka Zëvendësadministratori gjë për të thënë në lidhje me
17 këtë çështje?

18 Z. NILSSON: [Përkthim] Thjesht desha të them se jemi të
19 gatshëm të organizojmë një takim midis avokatit dhe klientit
20 të tij pas kësaj seance, nëse kjo kërkohet dhe është e
21 nevojshme.

22 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, z.
23 Zëvendësadministrator.

24 Pasi kam dëgjuar parashtimet tuaja, z. Pestman, do ta
25 nxjerr tani vendimin gojor të gjashtë në lidhje me kalendarin

1 e afateve për sa i përket kërkesës F38 të ZPS-së. Mbrojtja e
2 Fazliut ka kohë deri të premtën më 17 janar 2025, në qoftë se
3 dëshiron, t'i përgjigjet këtij parashtimi. Kurse ZPS-ja mund
4 të kundërpërgjigjet deri më 24 janar 2025.

5 Këtu përfundon urdhri im i gjashtë gojor.

6 Tani do t'i kthehem çështjes së riklasifikimit të
7 dokumentacionit që është një çështje mjaft e rëndësishme.

8 Sikurse e kam përmendur disa herë tashmë, kam vijuar me
9 procesin e riklasifikimit të disa dokumenteve. Është bërë
10 riklasifikimi i vendimit konfidencial F36 dhe keni tani në
11 dispozicion versionin e redaktuar të atij vendimi. Prandaj
12 kërkesën e Mbrojtjes së Kilajt dhe Thaçit në këtë drejtim e
13 konsideroj tani të tejkaluar.

14 Gjithashtu kam përmendur, se të gjitha numrat e
15 parashtimeve përkatëse që janë në dosjen hetimore KSC-BC-
16 2018-01, në lidhje me këtë, unë e kam ndërmend, si Gjykatëse e
17 Procedurës Paraprake, të udhëzoj Prokurorinë që ta kopjojë atë
18 dosje në dosjen e Çështjes 12. Kam marrë hapa që të siguroj që
19 të gjitha këto parashtime t'i jepen edhe Mbrojtjes, përveçse
20 kur janë në fuqi kufizimet e nevojshme. Vendimet përkatëse ose
21 vendimi përkatës në lidhje me këtë do të merret pas pushimit
22 të Gjykatës.

23 Në këtë pikë kohore, i pyes palët në qoftë se kanë ndonjë
24 koment tjetër në lidhje me riklasifikimin e dosjeve dhe
25 parashtimeve dhe gjithashtu ua kujtoj duhet të njoftojnë

1 paraprakisht në qoftë se do t'i referohen ndonjë informacioni
2 konfidencial për të kaluar në seancë private.

3 z. Prokuror.

4 Z. HAFETZ: [Përkthim] Nuk kemi asgjë për të shtuar.

5 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Znj. Menegon.

6 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Ne do të kërkojmë version të
7 paredaktuar ose me më pak redakte të gjitha parashtimeve të
8 njoftuara në çështjen përpara emërimit tonë. Për shembull, i
9 referohem parashtimit F28, që është Aktakuza e Ndryshuar më
10 tej e dorëzuar për konfirmim. Është me rëndësi për ne që ta
11 kuptojmë procesin që ka çuar në marrjen e vendimit e
12 Aktakuzës.

13 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

14 Z. Pestman.

15 Z. PESTMAN: [Përkthim] Faleminderit. Besoj që ju kam
16 kuptuar drejt, por ju nuk përmendët parashtimin me numër F38.
17 Do të kisha kërkuar që edhe ky parashtim të riklasifikohet
18 ose të përfshihet në urdhrin tuaj për riklasifikim.

19 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

20 Z. Admiraal.

21 Z. ADMIRAAL: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Jo, nuk
22 kemi asnjë gjë për të thënë. Faleminderit.

23 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Z. Edwards.

24 Z. EDWARDS: [Përkthim] Vetëm një gjë, e nderuar
25 Gjykatëse. Faleminderit që jeni angazhuar në mënyrë proaktive

1 në çështjen e riklasifikimit, sepse në dosjen 2018-01, e dimë
2 që ka shumë parashtrime të bëra *ex parte*.

3 Do t'ju kërkoj thjesht që të merrni parasysh që t'u
4 njoftohet palëve titulli i parashtrimeve edhe në qoftë se ato
5 janë *ex parte* sepse kjo do të ndihmoj që të dimë titullin e
6 atyre parashtrimeve dhe të marrim vendime të bazuara mbi
7 informacion lidhur me kërkesat tona të mundshme në të ardhmen
8 për riklasifikime të dokumenteve të tjera.

9 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

10 Për sa i përket kërkesës së znj. Menegon, konkretisht për
11 parashtrimin F28, kam marrë shënim këtë kërkesë dhe do ta
12 trajtojë atë në kohën e duhur.

13 Për sa i përket parashtrimit të z. Pestman, lidhur me
14 parashtrimin F38, kjo është përmendur edhe para pushimit dhe
15 ky parashtrim do të jepet Mbrojtjes në kuadër dokumentacioni
16 që do që e përmenda.

17 A ka edhe dikush diçka për të shtuar? E shoh që znj.
18 Menegon bën me dorë.

19 ZNJ. MENEGON: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po.

20 Sikurse e kam thënë dhe më herët Mbrojtja e z. Thaçi dhe ajo e
21 Kilaj dhe ZPS-ja kanë rënë dakord, në varësi të miratimit të
22 Panelit, që të suspendohen të gjitha afatet gjatë pushimit
23 dimëror të Gjykatës, domethënë, nga data 23 shkurt [Sipas
24 përkthimit] e deri më datën 12 janar, me përjashtim të afateve
25 për parashtrimin e mendimeve në lidhje me rishikimin e

1 paraburgimit. Dhe ne këtë propozim e parashtrojmë para jush, e
2 nderuar Gjykatëse, për të konfirmuar këtë marrëveshje midis
3 palëve në lidhje me afatet e parashtrimeve. Faleminderit.

4 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] E kam parasysh që ju si
5 palë jeni marrë vesh këtë në lidhje me parashtrimet dhe
6 shtyrjen e afateve të tyre deri pas përfundimit të pushimit të
7 Gjykatës. Dhe jam me të vërtetë e lumtur që ka një kompromis
8 të përgjithshëm midis palëve.

9 Nuk e di nëse palët kanë edhe diçka për të ngritur ose
10 ndryshe ta përfundojmë seancën e sotme.

11 Z. HAFETZ: [Përkthim] Ne nuk kemi asgjë për të shtuar.

12 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Nuk shoh asnjërin nga
13 palët që duan të marrin fjalën.

14 Me kaq përfundon seanca e sotme. Rikujtoj që pas
15 parashtrimeve me shkrim dhe atyre gojore që mora sot, kam
16 ndërmend që të nxjerrë Vendimin Kornizë për nxjerrjen e
17 materialeve me synimin e përsheptimit të procedurës.

18 Falënderoj palët dhe Zyrën Administrative për praninë dhe
19 gjithashtu përkthyesit, stenografët, teknikët audio-vizual dhe
20 personelin e sigurimit për ndihmën e tuaj.

21 Këtu përfundon seanca.

22 --- Konferenca për Ecurinë e Çështjes mbyllet
23 në orën 16.45

24

25